

1 E hënë, 27 tetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se keni ardhur, të gjithë.

7 Sekretare, të lutem thirr çështjen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është çështja KSC-BC-  
9 2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe  
10 Nasim Haradinajt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Shoh që  
12 Prokuroria ka të njëjtët persona si dje.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Me një shtesë, është stazhierja.  
14 Z. Rees, ndonjë ndryshim?

15 Z. REES: [Përkthim] nuk kemi asnjë ndryshim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.  
17 Cadman?

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm z. Buckley na është  
19 bashkangjitur sot.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Shoh që z.  
21 Gucati dhe z. Haradinaj janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

22 Përpara se të sjellim dëshmitarin, Trupi Gjykses do të  
23 trajtojë disa çështje.

24 Së pari, një urdhër me gojë lidhur me kërkesën që bëri z.  
25 Rees, për informacionin e ri që është paraqitur nga

1 Prokuroria.

2 Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja i ka dërguar një email  
3 Mbrojtjes dhe Trupit Gjykses në 14 tetor 2021 pasi ka mbajtur  
4 një seancë përgatitore me dëshmitarin 4842. Në kemi email,  
5 ZPS-ja informojë Panelin dhe Mbrojtjen se, ndër të tjera,  
6 dëshmitari ka dhënë disa informata të tjera në lidhje me disa  
7 masa të marra dhe detyrat e dëshmitarit.

8 Mbrojtja e Gucatit është e mendimit se në qoftë se ZPS-ja  
9 dëshiron të marrë dëshmi në lidhje me informacionin e ri të  
10 dhënë nga dëshmitari, atëherë ZPS-ja duhet t'i japë një  
11 deklaratë dëshmitari apo deklaratë për t'u nënshkruar ku të  
12 përcaktohet objekti i dëshmisë së atij dëshmitari dhe të  
13 kërkojë leje për të marrë atë material. Mbrojtja e Gucatit  
14 mbështetet në rregullat 102, 143 dhe 153 deri në 155 për të  
15 avancuar argumentin e vet.

16 Ndër të tjera ZPS-ja përgjigjet, se rregulli 95 kërkon  
17 vetëm njoftimin e palës kundërshtare por nuk ka kërkesë që  
18 vetëm dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi të mëparshme mund të  
19 thirren për të dëshmuar.

20 Trupi Gjykses vendos më poshtë.

21 Një lexim i kombinuar i paragrafëve 4(a) dhe 4(c) të  
22 nenit 21 kërkojnë që të akuzuarit të jepet njoftim i duhur për  
23 dëshmitë që do të paraqiten. Rregullat 95, 102 dhe 143 të  
24 Rregullores pasqyrojnë të njëjtën kërkesë.

25 Për të qenë të qartë, rregulli 102 nuk kërkon që

1 deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja do të thërrasë  
2 duhet të nxirren, kjo nuk do të thotë që dëshmitarët që nuk  
3 kanë deklarata nuk mund të dëshmojnë. Nuk do të thotë  
4 gjithashtu se çdo informacion për të cilët një dëshmitar do të  
5 dëshmojë duhet të përfshihet në një deklaratë të mëparshme.

6 Me këto fjalë duam të themi, se çdo informatë e re që  
7 mund të dalë gjatë dëshmisë, p.sh., pas përgatitjes, duhet  
8 megjithatë të plotësojë, të përmbushë kërkesën e njoftimit të  
9 duhur. Në qoftë se njëra palë nxjerr informacione që kalojnë  
10 tërësinë e fushave të reja të dëshmisë, kjo mund të krijojë  
11 një çështje të njoftimit të duhur.

12 Në rastin aktual, ZPS-ja ka vepruar në përputhje me  
13 paragrafët 52 dhe 53 të urdhrin për zhvillimin e procedurave  
14 dhe ka informuar Mbrojtjes dhe Trupin Gjykses mjaft përpara  
15 për dëshminë e dëshmitarit për informacionin që do të merret  
16 nga ky dëshmitar.

17 Urdhri për Zhvillimin e Procedurave nuk kërkon një  
18 deklaratë të re të dëshmitarit në një rast të tillë. Ajo  
19 thjesht kërkon që seanca përgatitore dhe njoftimi lidhur me  
20 çdo informacion si mbas detyrimeve për nxjerrje të palës  
21 thirrëse duke përfshirë, informacion të ri, t'i jepet palës  
22 kundërshtare dhe Trupit Gjykses.

23 Lidhur me thelbin e informacionit të ri, Trupi Gjykses  
24 është i kënaqur se informacioni shtesë është i kufizuar në  
25 fushëveprim dhe natyrë dhe nuk kalon përtej asaj që Mbrojtja

1 është njoftuar.

2 Përgatitja për pyetje të reja, është e kufizuar, si  
3 rrjedhje dhe kjo nuk do të shkaktojë dëmtim të Mbrojtjes  
4 gjithsesi.

5 Në qoftë se dëshmitari do pyetet nga ZPS-ja për të  
6 dëshmuar për çështje që kalojnë objektin e deklaratës së tij  
7 dhe njoftimin e 14 tetorit, Mbrojtja mund të kërkojë një  
8 ndërhyrje në atë moment; p.sh., të kërkojë më shumë kohë për  
9 t'u përgatitur apo që dëshmitari të thërritet përsëri për  
10 pyetje në lidhje me atë çështje.

11 Për këto arsye Trupi Gjykses e hedh poshtë kërkesën e  
12 Mbrojtjes së z. Gucati. Këtu përfundon urdhri me gojë.

13 Gjithashtu, Trupi Gjykses dëshiron të njoftojë palët për  
14 planet për pjesën e kësaj jave dhe javën tjetër.

15 Shpresoj që sot të përfundojë apo nesër në mëngjes ta  
16 përfundojmë dëshminë e z. Berisha. Pastaj do të dëgjojmë  
17 parashtrime për provat materiale që i kemi lënë për t'u  
18 vendosur gjatë dëshmisë së znj. Pumper. Trupi Gjykses do t'i  
19 trajtojë këto prova sipas kategorive. Sot do të dërgohet një  
20 email nga Punonjësi Ligjor që do të përcaktojë këto kategori.

21 Kategoria 1, deklaratat dhe Njoftimi Zyrtar i znj.  
22 Pumper. Këtu, ZPS-ja kujtohet që të lexojë një përmbledhje të  
23 shkurtër të deklaratave të dëshmitares në përputhje me urdhrin  
24 për Zhvillimin e Procedurave dhe urdhrin tonë me gojë të 21  
25 tetorit.

1           Kategoria 2, fragmente të Paketës 1;

2           Kategoria3, Njoftim Zyrtar për marrjen e materialeve nga

3 media;

4           Kategoria 4, Paketa 2;

5           Kategoria 5, fragmente nga Paketa 3;

6           Kategoria 6, korrespondenca nga organizatat ndërkombëtare;

7           [Kategoria] 7, ato pika apo dokumente që konsiderohen

8 juridikisht me rëndësi;

9           Kategoria 8, dëshmi të lidhura me të ; dhe

10          Nënta, dokumente të dorëzuara nga Mbrojtja.

11          Në përputhje me urdhrin tonë gojor të 21 tetorit,

12 Prokuroria kujtohet të vërë në dukje për çdo provë materiale

13 të paraqitur klasifikimin që propozon. Mbrojtjes do t'i

14 kërkohet që të japë një indikacion të qëndrimit të saj lidhur

15 me klasifikimin e propozuar.

16          Në qoftë se një provë materiale propozohet si

17 konfidenciale, ZPS-ja duhet gjithashtu të vërë në dukje se

18 versioni publik i redaktuar gjithashtu do të vihet në

19 dispozicion dhe në qoftë se kështu, kur? E njëjta gjë vlen

20 edhe për provat që do të paraqes Mbrojtja.

21          ZPS-së dhe çdo avokati të Mbrojtjes do t'i jepet 15

22 minuta për të bërë parashtrime për të gjitha kategoritë. Koha

23 që do të kalojë që do të përdorë ZPS-ja për leximin e

24 deklaratave të znj. Pumper nuk do të llogaritet në minuta.

25          Trupi Gjykses do të vendosë për pranueshmërinë dhe

1 klasifikimin pasi ka dëgjuar të gjithë argumentet e palëve.

2 Në varësi të kohës së mbetur mbas diskutimit për  
3 pranueshmërinë, Trupi Gjykues synon të fillojë me dëshmitarin  
4 tjetër 4842 ose këtë javë ose të enjten e ardhshme.

5 Vazhdojmë me dëshmitarin tjetër.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Ishte një diçka që duam ta  
7 trajtojmë që ishte përfshirë në urdhrin tuaj.

8 Në orën 19.28 dhe 20.13 dje Mbrojtja, ekipi i Mbrojtjes  
9 na dërgoi një kërkesë për nxjerrje me 12 pika në lidhje me  
10 informacionin e adresuar në regjistrin përgatitjes që keni  
11 për të cilin folët ju.

12 Neve kemi pranuar se do t'i përgjigjemi sa më shpejt të  
13 jetë e mundur, por mendoj që nuk është e nevojshme. Nuk ka  
14 arsye sepse këto tre dokumente të vogla të 14 tetorit gjatë  
15 përgatitjes duhet që të nxisin një hetim kaq të madh, nuk ka  
16 arsye sepse një kërkim i tillë nuk është bërë që më parë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kjo ka të  
18 bëjë me dëshmitarin tjetër, jo me z. Berisha?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë do  
21 ta trajtojmë më vonë.

22 Z. Koci, dëshironi të ngrini ndonjë çështje?

23 Z. KOCI: Po. [E padëgjueshme] -- për ndërprerjen. Po nuk  
24 më lejuan me marr -- po, nuk më lejuan pa shpjegim me marrë  
25 iPad-in ose laptopin tim. A ka mundësi me e marr në sallë për

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling (Vazhdon)

Faqe 7

1 shkak se po pengona në punë pa atë mjet të punës.

2 Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Na vjen  
4 keq për këtë z. Koci, por është një çështje që ka të bëjë me  
5 sigurinë. Të tjerë njerëz këtu kanë ndërmarrë disa masa të  
6 caktuara që i kanë lejuar ta bëjnë këtë gjë. Prandaj nuk ju  
7 kërkojmë dot ta merrni këtu laptopin. Ju kërkoj ndjesë.  
8 Shpresoj që do të mund të merrni njoftime të tjera në qoftë se  
9 neve ecim shumë shpejt dhe juve nuk keni kohë, ngrini dorën  
10 dhe na njoftoni.

11 Znj. Sekretare, mund të sillni dëshmitarin.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

14 Mirëmëngjes z. dëshmitar. Mund të uleni.

15 Sot, ZPS-ja do të vazhdojë dhe do të përfundojë pyetjet e  
16 saj. Pastaj Mbrojtja do t'ju bëj disa pyetje.

17 Z. Halling, keni fjalën.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

19 DËSHMITARI: HALIL BERISHA [Vijon]

20 Pyetje nga z. Halling: [Vijon]

21 Py. Mirëmëngjes z. Dëshmitar.

22 Pë. Mirëmëngjes.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, siç vura në  
24 dukje dje, ka dhe disa artikuj të medias të cilat duhet t'i --  
25 për të cilat duhet ta pyes dëshmitarin. Përpara se të

1 vazhdoja, doja të trajtoja diçka lidhur me ato artikuj që  
2 diskutuam dje.

3 Ne i pamë edhe njëherë procesverbalet për statusin e  
4 provës P125, në fakt, nuk i ish dhënë një numër MFI por nuk  
5 është plotësuar -- nuk është pranuar plotësisht. P125 është  
6 një përmbledhje artikujsh në shqip që janë pranuar me numër  
7 ERN 081361 deri në 081378. Ka dhe një përkthim në anglisht  
8 P125-ET, por ai mbulon vetëm një pjesë të këtyre dokumenteve,  
9 pra, 08137 [siç u përkthye] deri në 081373-ET.

10 081361 deri në 081362-ET dhe 081364 deri në 081367-ET, po  
11 ashtu përkthimi anglisht, nuk janë pranuar.

12 Z. Berisha foli për versionet shqip të këtyre  
13 transkriptove në fund të seancës.

14 01369 deri 081370-ET dhe 081374 deri në 081377 nuk janë  
15 në listën e dokumenteve për këtë dëshmitar por janë gjithashtu  
16 përkthime anglisht në këtë gamë dokumentesh. Të dyja këto  
17 lista provash nuk janë pranuar.

18 Ne mendojmë që përkthimi duhet gjithashtu të pranohet në  
19 të njëjtën kohë me origjinalin dhe të lidhen këto numra me  
20 P125.

21 Për sa i takon numërimin kjo mund të bëhet me numra dhe  
22 shoqëruar me përkthimin në anglisht bashkë. Diçka p.sh., si  
23 P125-ET.1.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni  
25 kundërshtim?



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling (Vazhdon)

Faqe 9

1 Z. REES: [Përkthim] Jo.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në

4 rregull. Pra, i japim një numër duke vënë pikë përpara, pra,  
5 pikë dhe numrin mbrapa.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

7 Pra, këto për të cilën po flasim, pra, 125-ET do të ishte  
8 ERN 081361 deri në 081362-ET dhe ky mund të jetë dokument  
9 publik.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet.

11 Z. HALLING: [Përkthim] 081364 deri në 081367-ET do të  
12 jetë 125-ET.2 dhe duhet të jetë publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet.

14 Z. HALLING: [Përkthim] 081369 deri në 081370 do të jetë  
15 125-ET.3 dhe ky do të jetë konfidencial.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet  
17 dhe klasifikimi është konfidencial.

18 Z. HALLING: [Përkthim] 081374 deri në 081377 do të jetë  
19 125-ET.4 do të jetë konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] ET-124?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Do të jetë 125-ET.4.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet  
23 dhe do të jetë konfidencial.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

25 Do të doja që Punonjësja e Gjykatës të hapi dokumentin,

1 të paraqesë dokumentin në ekran me numër ERN 12766 deri në  
2 12780. Dhe ju lutem t'ia tregoni dhe dëshmitarit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, është prova  
4 materiale nga lista me numër 492, ndërsa përkthimi në anglisht  
5 ka, i të njëjtit artikull ose artikuj, është në nënndarjen  
6 493.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund ta përsërisni  
8 numrin ERN.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po. 012766 deri në 012780. Dhe në  
10 listën tonë është 492 të provave materiale.

11 Py. Z. Berisha, një minutë. Z. Berisha, e shihni këtë  
12 artikullin në ekran?

13 Pë. [E padëgjueshme].

14 Py. A mund ta lexoni dot tekstin?

15 Pë. Po.

16 Py. Është artikulli që keni shkruar në 7 shtator 2020?

17 Pë. Nuk më kujtohet saktë kush e ka shkru se dhe këtu tek  
18 autori nuk është emri jem. Nuk më kujtohet saktë. Po me siguri  
19 që kam qenë në dijeni kur është publiku, se atë ditë kam qenë  
20 aty në zyrë.

21 Py. Pra, është një artikull nga gazeta inFokus; kështu?

22 Pë. Po.

23 Py. Për çfarë flet ky artikull?

24 Pë. Flet në lidhje me ato se çka ka pasë një prej dokumenteve  
25 që i kemi marrë.

1 Py. Z. Berisha, rrëfimi i kësaj gruas në këtë artikull është  
2 diçka që e patë në atë grupin, në paketën e dokumenteve që  
3 morët nga OVL UÇK-ja?

4 Pë. Po. Ishte në njërin prej dokumenteve aty.

5 Py. Në artikull thuhet dhe po citoj:

6 "Që inFokus nuk do të botojë asnjë hollësi lidhur me këta  
7 persona". - Mbaron citimi - Pse e morët këtë vendim?

8 Pë. Sepse, siç kam tregu edhe dje, kemi pasë dyshime së pari  
9 për autenticitetin e dokumenteve pastaj dhe për  
10 konfidencialitetin e tyre. Kështu që mos me e bë na një veprim  
11 që nuk duhet, kemi vendos që çdo informatë që mundet me qenë e  
12 ndijshme, mos me e publiku.

13 Py. Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Znj. Sekretare, kalojmë tek faqja  
15 tjetër të lutem.

16 Py. Z. Berisha, ky është një artikull që e keni shkruar në 9  
17 shtator 2020?

18 Pë. Po.

19 Py. Këtu përshkruhet se ZPS-ja ka thënë që nuk ka koment për  
20 dosjet që keni marrë në OVL UÇK që i përmendët dje; kështu?

21 Pë. Po.

22 Py. Paragrafi i fundit i këtij artikulli a përshkruan me  
23 saktësi masat mbrojtëse që morët ju kur përshkruat dosjet e  
24 OVL UÇK-së që kishit në zotërim? Botuat.

25 Pë. Po, siç thuhet edhe këtu, me kujdesin ma të madh, gazeta

1 inFokus ka vendos që me raportu për këto dokumente të cilat i  
2 ka posedu.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

4 Py. Z. Berisha, është ky artikulli që keni shkruar në 9  
5 shtator të vitit 2020?

6 Pë. Ky është artikulli i publikuar nga gazeta inFokus, po që  
7 nuk më kujtohet saktë se kush e ka shkru, përderisa edhe  
8 autori këtu nuk paraqitet.

9 Py. E kuptoj. Na përshkruani, ju lutem, shkurt se përse flet  
10 ky artikull.

11 Pë. Në këtë artikull tregohet që hetuesit e Zyrës së  
12 Prokurorit të Specializuar i kanë marrjet dosjet që i ka  
13 posedu gazeta inFokus.

14 Py. Në anën e majtë, në artikullin në shqip, ka dy fotografi.  
15 A mund të na thoni përse bëjnë fjalë këto fotografi?

16 Pë. Fotografia e parë është fotografia e, nëse nuk gabo, j  
17 është e bërë më 7 shtator, ku i kemi ba një fotografi nga larg  
18 të dokumenteve të cilat i kemi posedu. Dhe fotografia e dytë  
19 është dëshmia përmes të cilës tregojmë që hetuesit e Speciales  
20 i kanë marrë -- hetuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar  
21 i kanë marrë dokumentet prej inFokusit.

22 Py. Dhe ky është dokumenti i dorëzimit që ju tregova dje; apo  
23 jo?

24 Pë. E saktë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, dokumenti ka

1 numrin P100.

2 Kalojmë tek faqja tjetër.

3 Py. Z. Berisha, ky është artikulli që keni shkruar ju në 8  
4 shtator 2020?

5 Pë. Ky është një artikull që është shkruar edhe botuar prej  
6 gazetës inFokus, po nuk jam shumë i sigurt për autorin.

7 Py. Ky artikull flet për sekuestrimin e dokumenteve nga OVL  
8 UÇK-ja nga ZPS-ja; kështu?

9 Pë. Po.

10 Py. Ka një citat nga Fatos Klinaku në mes të artikullit. E  
11 keni dëgjuar ju z. Klinaku ta ketë thënë këtë?

12 Pë. Nuk më kujtohet.

13 Py. Në rregull.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

15 Py. Z. Berisha, po ky është artikulli që keni shkruar në 17  
16 shtator 2020?

17 Pë. Është artikull i gazetës inFokus, po që nuk më kujtohet  
18 autori.

19 Py. Përse flet ky artikull?

20 Pë. Ky artikull flet pasi zyrtarë, hetues të Zyrës së  
21 Prokurorit të Specializuar për herë të dytë kanë shkuar në  
22 zyrat e OVL UÇK-së dhe i kanë marrë dokumentet.

23 Py. Për aq sa ju dini, nga e mësuar atë informacionin për të  
24 cilin flet ky artikull?

25 Pë. Zyrat e OVL UÇK-së janë në qendër të Prishtinës, siç e

1 dini ju edhe çdo aksion që është bë aty, menjëherë është ba i  
2 ditun për publikun. Kështu që, për këtë informacion kanë shkru  
3 krejt mediat dhe me siguri prej atyne e kemi marrë vesh, pasi  
4 që nuk kemi qenë në terren na.

5 Py. Në qoftë se ju kuptova drejtë, i mësuar këto gjëra nga  
6 deklaratat për shtyp të OVL UÇK-së?

7 Pë. Jo. Thashë Zyrat e OVL UÇK-së janë në qendër të  
8 Prishtinës, ku ka dhe qarkullim të njerëzve. E aty çdo aksion  
9 që është bërë, është bërë menjëherë e ditun për publikun. Na  
10 nuk kemi qenë në terren. Kështu që me siguri e kemi mësuar  
11 prej mediave tjera, të cilat kanë raportuar për këtë çështje.

12 Py. E kuptoj. Pra, u raportua nga mediat e tjera dhe ju e  
13 mësuar prej tyre; kështu?

14 Pë. Po, me sa më kujtohet, pasi atë ditë nuk e di që ka pasur  
15 gazetarë të inFokusit në terren.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Do të kalojmë në faqen tjetër.

17 Py. Z. Berisha, këtë artikull ju e keni shkruar në 22 shtator  
18 të vitit 2020?

19 Pë. Është artikull i publikun prej gazetës inFokus, po që nuk  
20 më kujtohet autori.

21 Py. Po ky përse flet?

22 Pë. Ky flet, ky artikull tregon për rastin e tretë që  
23 hetuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar shkojnë në  
24 zyrat E OVL UÇK-së edhe i marrin dokumentet.

25 Py. Aq sa dini, ju lutem, na përshkruani informacionin që --

1 si e mësuar ju këtë informacion që raporton ky artikull?  
2 Pë. Edhe për këtë artikull, sikur në artikullin e kaluar, në  
3 këto ditë ka qenë me rëndësi dhe ka qenë në qendër të  
4 vëmendjes ndodhitë në OVL UÇK-në edhe mediat kanë raportuar me  
5 shumë shpejtësi. E me siguri që ky ka qenë një artikull i  
6 marrë prej çka kanë raportuar mediat tjera, pasi as atë ditë,  
7 nuk më kujtohet, që inFokusi nuk ka pasur gazetarë në terren  
8 në Prishtinë.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

10 Py. Po ky është artikull që keni shkruar në 17 shtator të  
11 vitit 2020?

12 Pë. Po, ky është artikull që e kam shkruar unë.

13 Py. Çfarë tregon kjo fotografia këtu në artikull?

14 Pë. Kjo fotografi është marrë prej kamerave të sigurisë në  
15 zyrën e veteranëve, në zyrën e OVL UÇK-së kur personi i  
16 panjohur jua sjell dokumentet.

17 Py. Si e morët ju fotografinë?

18 Pë. Nga rrjetet sociale.

19 Py. A e mbani mend se ku nga rrjetët sociale?

20 Pë. Nuk jam shumë i sigurt, po me sa më kujtohet, është  
21 publiku vetë nga Organizata e Veteranëve të Luftës, nga dikush  
22 prej zyrtarëve të organizatës.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të shkojmë në faqen tjetër.

24 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që e keni shkruar më  
25 7 shtator 2020?

1 Pë. Po.

2 Py. Për çfarë flet ky artikull?

3 Pë. Ky është paralajmërim për konferencën e parë që e ka  
4 mbajtur OVL UÇK-ja në lidhje me dokumentet.

5 Py. Kjo është konferenca për shtyp ku keni marrë pjesë edhe  
6 ju apo jo?

7 Pë. E saktë.

8 Py. Z. Berisha, ne folëm dje dhe thamë që z. Haradinaj ju  
9 kishte thënë që do të kishte një njoftim për shtypin për sa i  
10 takon organizimit të konferencës për shtyp.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë për  
12 faqen 105 deri në 106 të transkriptit në kohë reale të ditës  
13 së djeshme.

14 Py. A është shkruar ky artikull përpara apo pas këtij  
15 njoftimi publik?

16 Pë. Me sa më kujtohet, ky është i shkruar përpara njoftimit  
17 publik. Me sa më kujtohet.

18 Py. Si e bëri këtë njoftim publik, si e komunikoi këtë  
19 njoftim publik OVL-ja e UÇK-së?

20 Pë. Nuk më kujtohet saktë, nëse ka qenë përmes rrjeteve  
21 sociale ose email, nuk më kujtohet saktë.

22 Py. Faleminderit.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

24 Py. A është ky një artikull që keni shkruar me datë 16  
25 shtator 2020, z. Berisha?



1 Pë. Muj me konfirmu që është artikull i gazetës inFokus, po  
2 nuk më kujtohet autori.

3 Py. Me aq sa dini ju, a mund të na përshkruani sesi e keni  
4 mësuar informacionin e dhënë në artikull?

5 Pë. Nuk është që më kujtohet sigurt, megjithatë duke e pasur  
6 parasysh si kanë rrjedhë ngjarjet ato ditë, gjithçka është  
7 bërë shumë shpejt publike nëpër media. Kështu që po besoj se  
8 edhe kjo ka qenë në koordinim, e marrë prej mediave tjera.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja tjetër.

10 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që e keni shkruar ju  
11 më datë 22 shtator 2020?

12 Pë. Ka mundësi, po nuk jam shumë i sigurt.

13 Py. A e dini se çfarë është kjo fotografia në këtë artikull?

14 Pë. Është fotografi prej kamerave të sigurisë në zyrën e  
15 Veteranëve, në zyrën e OVL-së ku personi në fjalë i ka sjellë  
16 dokumentet.

17 Py. Me aq sa dini ju, kush jua ka dhënë këtë foto?

18 Pë. Në artikull, siç po shihet, ka dhe video prej kamerave të  
19 sigurisë më poshtë. Fotografia e marrë është prej këtyre  
20 videove të cilat janë publiku, me aq sa më kujtohet, nga  
21 zyrtarë të OVL UÇK-së në rrjetin social Facebook.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

23 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që e keni shkruar më  
24 datë 22 shtator 2020?

25 Pë. Nuk më kujtohet saktësisht.

1 Py. Për çfarë flet ky artikull?

2 Pë. Flet për herën e tretë që personi që ua ka dërguar  
3 dokumentet.

4 Py. Me aq sa dini ju, a mund të na thoni sesi keni mësuar  
5 rreth këtij zhvillimi?

6 Pë. Me aq sa më kujtohet, ka qenë pasi e kemi përcjellë  
7 online konferencën e tretë për këto dokumente.

8 Py. Faleminderit.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

10 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që keni shkruar me 7  
11 shtator 2020?

12 Pë. Po.

13 Py. Dua t'ju pyes për fillimin e këtij artikulli veçanërisht.

14 "Zyra e Prokurorit të Specializuar refuzon që të japë  
15 ndonjë koment sa i takon rrjedhjes së dokumenteve sekrete".

16 "Në mesin e tyre ka emra, adresa dhe numra telefonash të  
17 dëshmive, dëshmitarëve të cilët janë intervistuar nga Task  
18 Forca Speciale Hetimore".

19 Ju lutem, a mund të na shpjegosh se çfarë është raportuar  
20 në këtë pjesë që citova nga ky artikull?

21 Pë. Siç e kam shpjeguar edhe dje, posa i kemi marrë  
22 dokumentet i kemi shkruar Zyrës së Prokurorit të Specializuar  
23 për me e pyet për autenticitetin edhe me pyet se a janë  
24 konfidenciale dhe autentike këto dokumente. Zyra e Prokurorit  
25 Specializuar nuk ka dhanë përgjigje të saktë, nuk ka tregu, as

1 nuk e ka pohuar as nuk e ka mohu kurrëgjë në lidhje me këto  
2 dokumente. Pastaj na tuj i pasur në pronësi këto dokumente,  
3 aty në gazetën inFokus, kemi tregu se çka përfaqësisht, muj me  
4 pa çka përfaqësisht kanë këto dokumente.

5 Py. Nëse ju kuptova drejtë, informacioni që keni raportuar  
6 nuk ka ardhur nga ZPS-ja po nga inspektimi i dokumenteve të  
7 sekuestruara prej jush; është kështu?

8 Pë. Këto, afërsisht nga fundi i artikullit, shkruan edhe  
9 përgjigja që është dhënë prej Zyrës së Prokurorit të  
10 Specializuar, konkretisht prej zëdhënësit të kësaj zyre z.  
11 Cristopher Bennett. Ai -- aty shkruan që z. Bennett ka veç na  
12 ka falenderu për komunikimin që e kemi pyetur edhe as që nuk  
13 ka komentuar kurrëgjë në lidhje me këto dokumente.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

15 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që keni shkruar në  
16 datë 16 shtator 2020?

17 Pë. Nuk më kujtohet nëse e kam shkruar unë.

18 Py. A jeni i njohur me informacionin që paraqet ky artikull?

19 Pë. Pak a shumë, po nuk po më kujtohet shumë saktësisht.

20 Py. Titulli i artikullit është "Nasim Haradinaj sulmon mediat  
21 që nuk i publikuan informatat sekrete të Speciales"; a nuk  
22 është kështu?

23 Pë. Përveç kjo fjala "sulmon" është në thonjëza që nuk e ka  
24 kuptimin bukalisht se e ka sulmuar.

25 Py. E kuptojmë. Dua t'ju pyes lidhur me disa pjesë të këtij

1 artikulli për të parë në qoftë se dini rreth saj. Kjo është  
2 pjesa e parë.

3 "Personi i dytë përgjegjës i OVL UÇK-së tha se kur flitej  
4 për OVL-në media nuk heziton që të botojë përfshirë këtu edhe  
5 informacion sensitiv, por jo kur flitet për Gjykatën  
6 Speciale".

7 Citim:

8 "Në një mënyrë, ekspozon edhe shtypin tonë dhe ndërkohë  
9 ju keni pasur një sfidë goxha të madhe dhe nuk keni bërë më  
10 andej, ndërkohë që të huajt të cilët na kanë dëmtuar  
11 respektohen më shumë sesa njerëzit tonë dhe në fund të ditës,  
12 bëhen -- janë bërë gabime por janë gabime të rënda, - thotë z.  
13 Haradinaj".

14 Z. Berisha, a mund të më thoni keni dëgjuar ju me veshët  
15 tuaj këtë deklaratë të z. Haradinaj, z. Berisha?

16 Pë. Kam qenë pak a shumë në dijeni për këtë deklaratë, po nuk  
17 më kujtohet saktë nëse e kam dëgjuar vetë.

18 Py. A e dini në qoftë se shtypi në Kosovë ka botuar  
19 pretendime të rreme të OVL UÇK-së në të shkuarën?

20 Pë. Nuk e di nëse e kuptova saktë pyetjen, pretendimet të  
21 rrejshme të OVL-së?

22 Py. Po. A ka ndonjë botim të historive për pretendime të  
23 veteranëve të rremë të luftës? A keni dëgjuar për këtë?

24 Pë. Po, në atë kohë nuk kam qenë gazetar i gazetës inFokus  
25 kam qenë me një media tjetër. Në atë kohë e di që ka pasur

1 raportime të mediave të ndryshme ku kanë zbuluar edhe emra për  
2 disa veteranë që dyshohej që nuk -- që janë veteranë të  
3 rrejshëm. Këto emra, me sa më kujtohet, janë marrë prej një  
4 prokurori në Kosovë ose diçka e tillë.

5 Py. Ju thatë përpara sesa të bashkoheshit me inFokusin, a  
6 jeni në dijeni në qoftë se gazeta inFokus ka botuar artikuj të  
7 tillë?

8 Pë. Nuk jam në dijeni pasi që në atë kohë kam qenë gazetar i  
9 terrenit edhe si gazetar i terrenit kam pasur goxha pak kohë  
10 që me i lexuar mediat, mediat online.

11 Py. Z. Berisha, është një gazetar specifik që përmendet në  
12 këtë artikull me të cilin ka folur z. Haradinaj, a e dini ju  
13 kush është ky gazetar?

14 Pë. Jo, nuk më kujtohet. Thashë edhe ma herët, që unë jam veç  
15 në dijeni pak a shumë të një deklaratë të tillë, po nuk më  
16 kujtohet nëse e kam dëgjuar ose se për kënd e ka pasur fjalën,  
17 me kënd ka biseduar.

18 Py. Dua të të lexoj edhe këtë pjesën tjetër:

19 "Haradinaj tha më tej që media i kishte dokumentet para  
20 syve por nuk guxuan që ti botojnë ata, përveç inFokus".

21 A jeni në dijeni të z. Haradinaj që ta ketë thënë këtë  
22 gjë?

23 Pë. Unë, siç thashë edhe ma herët, jam në dijeni pak a shumë  
24 të kësaj deklaratës për të cilën fol ky artikulli këtu, po nuk  
25 më kujtohen shumë gjëra specifike se çka ose si i ka thanë.

1 Py. Tani, në këtë artikull, a ka një përshkrim të mënyrës  
2 sesi gazeta inFokus i ka trajtuar dokumentet për të cilat po  
3 diskutojmë?

4 Pë. Po, është në pjesën e fundit të artikullit, ku edhe një  
5 herë tregon që gazeta inFokus ka qenë shumë e kujdesshme edhe  
6 nuk ka publiku informata sekrete, që mundën me qenë sekrete,  
7 pavarësisht që kemi pasur dyshime për autenticitetin edhe  
8 konfidencialitetin e tyre.

9 Py. Në rregull. Pra, thuhet që inFokusi nuk ka botuar  
10 informacion sekret dhe të ndjeshëm në të; a nuk është kështu?

11 Pë. [E padëgjueshme] -- siç e ceka dhe ma herët, nuk e --  
12 kemi qenë në dyshim të se a janë këto dokumente autentike së  
13 pari edhe e dyta se a janë konfidenciale. Megjithatë nuk -- na  
14 kemi vendosë që edhe pse jemi [të] dyshim të nuk kemi ditë të  
15 sigurt nëse janë konfidenciale ose autentike, që mos me  
16 publiku diçka që mundet me qenë sekrete.

17 Py. Dhe në fund të këtij artikulli lidhur me deklaratën e z.  
18 Haradinaj thuhet:

19 "Këto dosje janë marrë më pas nga inFokusi, pra, janë  
20 marrë nga hetuesit e zyrës së Prokurorit të Specializuar".

21 Edhe ky është një përshkrim i saktë i gazetës inFokus  
22 lidhur me këto materiale; a nuk është kështu?

23 Pë. Po. Siç e dëshmoj edhe dokumenti ma herët, dy hetues të  
24 Zyrës së Prokurorit të Specializuar i kanë marrë dokumentet  
25 prej gazetës inFokus edhe ne i kemi raportuar për këtë punë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

2 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull që keni shkruar më 7  
3 shtator 2020?

4 Pë. Po.

5 Py. Ju lutem, na shpjegoni se çfarë tregojnë fotografitë?

6 Pë. Këto fotografi janë të bëra menjëherë pasi i kemi marrë  
7 dokumentet edhe kemi ardhur në zyrën e gazetës inFokus.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër. Kjo  
9 është gjithashtu edhe faqja e fundit.

10 Py. Z. Berisha, a është ky një artikull i shkruar prej jush  
11 me datë 7 shtator 2020?

12 Pë. Më duket që po.

13 Py. Ka disa fotografi në versionin në shqip të cilat janë të  
14 ndërprera, janë të prera nga faqja. Ju lutem, z. Berisha, a  
15 mund të përshkruani se çfarë përfaqësojnë këto fotografi? Në  
16 qoftë se ju duhet që ta zmadhojmë faqen, mund ta bëjmë këtë  
17 gjë.

18 Pë. Këto dokumente, mesa po e shoh, janë dokumente të cilat  
19 kanë qenë pjesë e atyre dosjeve që i kemi poseduar.

20 Py. Dua që të lexoni këtë pjesë të artikullit:

21 "Dosjet përmbajnë shumë emra të dëshmitarëve pjesa më e  
22 madhe e të cilëve serbë po gjithashtu edhe emra shqiptarë,  
23 romë, ashkali e të tjerë".

24 Tani, z. Berisha, ju thatë që në fillim e keni inspektuar  
25 i keni kaluar dokumentacionin dhe në qoftë se e kam të saktë,

1 në qoftë se e mbaj mend siç duhet, dje ju thatë që keni  
2 harxhuar rreth 30 deri në 45 minuta për ta inspektuar  
3 informacionin. A është e saktë kjo?

4 Pë. Po, është e saktë. Unë bashkë me redaktorët e gazetës  
5 inFokus i kemi shikuar këto dokumente se çka muj me poseduar,  
6 ndërsa gazetarët e gazetës inFokus nuk janë lejuar që me hy  
7 brenda. Kemi qenë veç unë e bashkë me redaktorët.

8 Py. Informacioni nga segmenti, nga fragmenti që u lexova a  
9 është verifikuar gjithashtu prej jush gjatë këtij kontrolli  
10 fillestar?

11 Pë. Gjatë këtij kontrolli të dokumenteve, ne kemi pa që aty  
12 ka shumë korrespondenca të kësaj Task Forcës Speciale të  
13 Hetimit me zyrtarë edhe prokurorë të shtetit të Serbisë. Edhe  
14 atyre ju kanë kërkuar me ju siguri dëshmitar, të cilët i kanë  
15 përmend me emra, të cilët i kanë përmend me adresa, që zyra e  
16 Task Forcës Speciale të Hetimit i din, po që me i verifikuar  
17 adresat prokuroria dhe zyrtarët serb. Kështu që, aty po, ka  
18 pasur emra të këtyre personave që Task Forca ka synuar me i  
19 intervistuar dhe për të cilët ka kërkuar ndihmë nga Prokuroria  
20 e Serbisë nga prokurorë të Serbisë.

21 Py. Dëshiroj të lexoj një tjetër fragment të fundit nga ky  
22 artikull. Në të thuhet, pra, ka lidhje me një prej  
23 fotografive, thuhet:

24 "Më poshtë jepet një listë e dëshmitarëve që kërkohet të  
25 intervistohen e cila është redaktuar për arsye sigurie, pjesa



1 më e madhe e dosjeve që ka marrë inFokus përmbajnë kërkesa të  
2 ngjashme dhe emra dëshmitarësh”.

3 Z. Berisha, juve përmendët që fotografia është pjesë e  
4 dokumenteve që keni marrë nga OVL e UÇK-së, ndërkohë këtu  
5 thuhet, në artikull, që pjesa më e madhe e këtyre dosjeve  
6 përmbajnë kërkesa të ngjashme dhe emra të dëshmitarëve. Këto  
7 informacion e keni mësuar ndërkohë që e keni kontrolluar  
8 materialin e marrë?

9 Pë. Po. Siç e thashë ma herët, një pjesë e këtyre dokumenteve  
10 kanë qenë kërkesa të zyrës së Prokurorit -- më fal, kanë qenë  
11 kërkesa të Task Forcës Speciale të Hetimit drejtuar  
12 prokurorëve serbë që me ju siguruar dëshmitarë të cilët janë  
13 përmend me emra.

14 Py. Tani, Z. Berisha, të gjithë artikuj që kemi diskutuar sot  
15 paradite, a është e saktë që këto artikuj ja keni dhënë ZPS-  
16 së?

17 Pë. Nuk e kuptova pyetjen.

18 Py. Gjatë intervistës me ZPS-në, juve keni dhënë artikuj të  
19 caktuar mediatik, të medias pra, ZPS-së, a janë këta artikuj  
20 që kemi diskutuar sot në mëngjes, artikuj që i keni dhënë ZPS-  
21 së?

22 Pë. Një pjesë të këtyre artikujve i ka pasuar Zyra e  
23 Prokurorit të Specializuar që mu kanë paraqit mu, me sa më  
24 kujtohet, e një pjesë tjetër i kam pasur me vete për me qenë  
25 vetë i gatshëm edhe me u përgatit se çka muj me qenë pyetjet.

1 Py. Z. Berisha, në të gjithë këta artikuj që kemi diskutuar,  
2 a janë këta artikuj të saktë me aq sa dini ju?

3 Pë. Për aq kohë sa kohë sa kam punuar në gazetë inFokus, të  
4 gjithë artikujt që i kemi publiku kanë qenë të saktë edhe kanë  
5 qenë, sa i di unë, nuk kanë pasur ndonjë devijim.

6 Py. Z. Berisha, në të gjithë artikujt që kemi parë dje dhe  
7 sot ju apo gazeta inFokus, a ka thënë që ka qenë ZPS-ja dhe jo  
8 OVL UÇK-së që i ka dhënë dokumentet që kemi diskutuar medias?

9 Pë. Që këto dosje, nëse e kuptova saktë, a thatë që nëse këto  
10 dosje i kemi marrë nga ZPS-ja ose OVL-ja apo?

11 Py. Jam kurioz të di në qoftë se ndonjë nga artikujt që  
12 kaluam, në qoftë se ka pasur ndonjë raportim që thoshte që  
13 ZPS-ja është ajo që ia ka dhënë dokumentet medias.

14 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar, ne mund ta shikojmë këtë  
15 gjë nga artikujt vetë ato çfarë na u treguan.

16 DËSHMITARI: Jo, na nuk e dimë. Nuk kemi raportuar na që  
17 ZPS-ja i ka dhënë gazetës inFokus dokumente.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për këtë gamë  
19 artikujsh të medias, domethënë, nga 012766 deri 027810 ne do  
20 të kërkojmë që edhe grupi i artikujve dh përkthimet në  
21 anglisht të pranohen gjithashtu.

22 Për qartësim, ne vërejmë se artikujt në faqen 102768 të  
23 riprodhohen në dokumentin P100. Riklasifikimi publik i P100  
24 duhet që të shtyhet në pritje të zgjidhjes së mocionit për të  
25 shtuar në listën e dëshmitarëve të ZPS-së edhe W04876. Ne

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling (Vazhdon)

Faqe 27

1 kërkojmë që në këtë paketë informacionesh të -- edhe kjo  
2 paketë informacionesh të klasifikohet si konfidenciale për të  
3 njëjtat arsye. Në kërkesë shtohet edhe W04876 dhe ZPS-ja nuk  
4 ka kundërshtime që kjo paketë artikujsh të klasifikohet si  
5 publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vijoni.

7 Z. REES: [Përkthim] Jemi të lumtur që dëgjojmë  
8 riklasifikimin si publik të këtyre dokumenteve.

9 Ndërkohë që sa i takon dokumentit P100, nuk e mbaj mend  
10 justifikimin për shtyrjen e klasifikimit të këtij dokumenti.  
11 Kështu që nuk e kuptoj sepse nuk duhet të jetë publike dhe ky  
12 dokument. Jemi dakord me parashtrimin e z. Halling që kjo  
13 paketë dokumentesh duhet të riklasifikohet si publike.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sa i  
16 takon P100, ne po presim në qoftë se dëshmitari do të lejohet  
17 apo jo, por e kuptojmë kërkesën.

18 Z. REES: [Përkthim] Atëherë sa i takon këtij dokumenti,  
19 në qoftë se dëshmitari jep prova apo jo, pranimi i dokumentit  
20 në vetvete nuk mund të ndryshojë riklasifikimin e vet në qoftë  
21 se pranohet. Kështu që parashtrojmë që këto dokumente duhet të  
22 klasifikohen siç duhet si publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

24 Faleminderit. Por kam marrë vendim lidhur me këtë çështje.

25 Tani, a po bëni një ofertë për dokumente të tjera, apo

1 dëshironi shtyrjen e të gjithë atyre.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Do të donim që t'i ofronim si  
3 prova materiale atonë këtë kohë. Por, ndërkohë, thjeshtë  
4 kërkojmë shtyrjen e riklasifikimit si publike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
6 kundërshtim?

7 Z. REES: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim lidhur me ofrimin  
8 e dokumenteve si prova materiale. Por, në lidhje me këto  
9 dokumente, e ndoqa vendimin tuaj, të nderuan Gjykatës, se  
10 ndoshta mënyra për ta trajtuar atë që dokumentet në vetvete të  
11 mund të klasifikohen si publike në përjashtim të përfaqësimit  
12 të dokumenteve të ofrimit dhe që janë dhënë në seancë private.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju po i  
14 ofroni këto nga 102 deri në 1027766 si një provë materiale?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kjo. Këtë po kërkojmë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po 102780  
17 si një grup të dytë provash materiale?

18 Z. HALLING: [Përkthim] E gjithë gama 102766 deri në  
19 102780 do të ishte një provë e vetme materiale.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
21 rregull. T'i caktojmë një numër këtyre dokumenteve. Ato  
22 pranohen.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Gjykatës të nderuar,  
24 dokumenti merr numrin P129.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling (Vazhdon)

Faqe 29

1 pozicionin tuaj, po ne deri nesër do marrim një vendim lidhur  
2 me të.

3 Z. REES: [Përkthim] Për sa i takon provave të këtij  
4 dëshmitari dhe në zbatim të rregullit që procedurat duhet të  
5 jenë në seancë publike, në përjashtim të rasteve kur një gjë e  
6 tillë nuk është e mundur ose nuk është e nevojshme, mua më  
7 duket që, në këto rrethana, ne mund të trajtojmë këto prova  
8 materiale në seancë publike përveç një imazhi, një pamjeje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vendimi  
10 është që ato do të mbeten si të klasifikuar më përpara deri sa  
11 të bëhet, të merret vendimi për pranueshmërinë e dëshmitarit.

12 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se këto dokumente janë të  
13 ofruara si prova materiale më vete dhe nuk do të ketë probleme  
14 me pjesën tjetër të dokumenteve që të dëshmohen që të përdoren  
15 në seancë të hapur apo jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,  
17 nuk do të vazhdojmë më me këtë çështje sepse kemi marrë një  
18 vendim lidhur me të.

19 Ndonjë pyetje tjetër z. Halling?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje të tjera.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,  
22 mund të vazhdoni me marrjen në pyetje të dëshmitarit.

23 Z. REES: [Përkthim] Mund të vijoj me marrjen në pyetje në  
24 seancë publike apo private?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne jemi në

1 seancë publike. Nuk është kështu? Dhe ju e dini se çfarë  
2 parashikojnë rregullat. Mos përdorni emrat.

3 Z. REES: [Përkthim] Në rregull. Unë në fakt më duken  
4 rregullat gjithmonë e më të komplikuar dhe më të paqarta.

5 Pyetje të palës tjetër nga z. Rees:

6 Py. Përpara sesa të jepni provën -- dëshminë z. Berisha,  
7 pavarësisht që jeni në prani të avokatit tuaj, ZPS-ja tha se  
8 dëshironte ta bënte të qartë në procesverbal lidhur me faktin  
9 që vetë Prokurori i Specializuar ka thënë që ZPS-ja, nuk do të  
10 ndjekë penalisht për asgjë. Ti nuk ke bërë asgjë gabim. Kështu  
11 që ta kuptosh për aq sa vlen, që unë jam plotësisht dakord me  
12 këtë. Domethënë, ti nuk ke bërë asgjë gabim. Nuk ke bërë asnjë  
13 gabim. Në rregull?

14 Pavarësisht kësaj unë do të doja t'ju bëja disa pyetje,  
15 thjesht për të marrë më shumë informacion rreth kronologjisë  
16 së çështjeve, artikujve që keni botuar dhe keni bërë publike,  
17 përmbajtjen e këtyre artikujve dhe që janë bërë po ashtu  
18 publike. Atëherë, ju lutem, kini parasysh që nuk bëj asnjë  
19 lloj kritike për personin tuaj dhe nuk mendoj që keni bërë  
20 ndonjë gjë gabim.

21 Py. Përpara se të pranoni të jepni dëshmi, a kërkuat diçka  
22 nga prokuroria Speciale sipas atyre fjalëve që tha z. Halling  
23 përpara avokatit tuaj ndonjë premtim ndonjë gjë?

24 Pë. Më fal, nëse mundesh edhe njëherë me përsërit pyetjen.  
25 Nuk e kisha shumë të qartë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Avokati  
2 thotë që mund të përdorësh një fjalë tjetër sesa fjala zotim  
3 apo premtim.

4 Z. REES: [Përkthim]

5 Py. Përpara se të jepnit dje dëshmi, kishit kërkuar ndonjë  
6 garanci nga Prokuroria lidhur me statusin tuaj?

7 Pë. E vetmja gjë që kam kërkuar është që me pasur edhe  
8 avokatin tim, z. Arianit Koci këtu.

9 Py. Më parë ju kanë intervistuar Prokuroria?

10 Pë. Po, më kanë -- kam qenë intervistuar në Kosovë.

11 Py. Dhe kjo ka ndodhur në 25 gusht të vitit 2021?

12 Pë. Po me sa më kujtohet.

13 Py. Kur ju kërkoi për herë të parë Prokuroria që të jepnit  
14 intervistë?

15 Pë. Nuk më kujtohet saktë, megjithatë kam pasur një thirrje  
16 sa kam qenë gazetar në inFokus nëse nuk gaboj, ku më është  
17 thanë që dëshirojnë me bisedu me mu një hetues ose dikush i  
18 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, po që ai takim nuk ka  
19 ndodhë asnjëherë. Nuk më kanë kontaktuar më. Tani para asaj  
20 date më kanë kontaktuar, nëse nuk gaboj, një javë ose dy ma  
21 herët, po nuk jam shumë i sigurt. Nuk jam shumë i sigurt me  
22 data.

23 Py. Mos u shqetësoni shumë për datën konkrete. Por që ta  
24 kuptojmë, në fund të shtatorit të vitit që shkoi e kishe  
25 përfunduar punën në gazetën inFokus dhe se për herë të parë të

1 thanë të flisje me dikë në shtatorin që shkoi, por nuk u la  
2 ndonjë takim dhe nuk dëgjove më prej tyre deri një javë apo  
3 diçka më shumë se data 25 gusht e këtij viti; kështu?

4 Pë. Me sa më kujtohet po. Po nuk jam shumë i sigurt. Ajo çka  
5 e di sigurt është që kam qenë edhe një herë ma herët i  
6 kontaktuar.

7 Py. Ky kontaktimi në gusht, ishte kontakti i parë me telefon,  
8 email apo me ndonjë formë tjetër?

9 Pë. Përmes telefonit.

10 Py. Dhe kush të kontaktoi përmes telefonit?

11 Pë. Me sa më kujtohet, në kontaktin e parë dhe që kam  
12 vazhduar bisedën ka qenë e nderuara Prokuroria, znj. Valeria  
13 Bolici.

14 Py. Pas këtij kontakti përmes telefonit në gusht, pastaj more  
15 një fletë-thirrje që të paraqiteshe për një intervistë?

16 Pë. Kur në intervistimin e parë në Kosovë nuk kam pasur unë  
17 fletë-thirrje.

18 Py. Atëherë, të themi, more ndonjë ftesë për të shkuar, me  
19 shkrim, për të marrë pjesë në intervistën e 25 gushtit?

20 Pë. Jo, nuk më kujtohet që kam pasur ftesë me shkrim.

21 Py. Po çfarë të tha Prokurorja lidhur me statusin që kishe  
22 për atë intervistë? Në çfarë cilësie do të intervistoheshe? Si  
23 të tha?

24 Pë. Më ka thanë që kam me u intervistuar në lidhje me çështjen  
25 në fjalë edhe që jam në cilësi të dëshmitarit me sa më



1 kujtohet, po.

2 Py. E pyetët znj. Bolici se në çfarë cilësie do të ishte ti në  
3 atë intervistë? Si do të pyesnin, do të intervistonin në çfarë  
4 cilësie?

5 Pë. Po, e kam pyetur edhe më është thënë që nuk jam në  
6 cilësinë e të dyshuarit.

7 Py. Përpara sesa ti pranove të marrësh pjesë në këtë  
8 intervistim të 25 gushtit, pra, e pyete Prokuroren dhe ajo t'u  
9 përgjigj se nuk ishte në cilësinë e të dyshuarit. Atëherë pse  
10 kërkove që i pranishëm në intervistë të ishte edhe avokati yt.

11 Pë. Sepse unë jam gazetar edhe, me thanë të drejtën, unë nuk  
12 kam pritë që kam me qenë i ftuar as për intervistim si  
13 dëshmitar e as si i dyshuar se unë e kam kry punën time, me  
14 aq sa di, me përpikëri e në mënyrë profesionale. Kështu që nuk  
15 e kam pritë unë së pari që kam me qenë i ftuar. Kjo ka qenë  
16 paksa si e çuditshme për mu. Edhe kur më ashtë bërë ftesa, unë  
17 kam kërkuar që bashkë me mu me qenë edhe z. Arianit Koci.

18 Py. Përsëri, sa për të të siguruar që nuk -- me këto që po  
19 them nuk po vë në dyshim se ti e ke bërë punën në mënyrë  
20 profesionale.

21 I kërkove z. Koci, avokatit, që të konfirmonte me znj.  
22 Bolici, se ti nuk ishte i dyshuar përpara se të merrje pjesë në  
23 një intervistën e 25 gushtit?

24 Pë. Jo, mu përderisa më është thënë që nuk jam i dyshuar unë  
25 e kam marrë këtë gjë si të mirëqenë.

1 Py. Ti ke punuar si gazetar në inFokus, ndërsa më parë ke  
2 punuar në Klan Kosovën; kështu?

3 Pë. E saktë.

4 Py. Po ke punuar për ndonjë organ tjetër shtypi apo agjenci  
5 mediash në Kosovë?

6 Pë. Jo, këto janë të vetmet që kam punuar.

7 Py. Kur u largova nga Klan Kosova i ruajte kontaktet me  
8 kolegët që kishe në atë agjenci të medias?

9 Pë. Po, sigurisht, kam ruajtur kontaktet shoqërore që kam  
10 pasur me shumë prej gazetarëve aty.

11 Py. Dhe ndërkohë kishe krijuar miqësi edhe me gazetarë të  
12 tjerë që punonin në agjenci të ndryshme të medias në Kosovë  
13 apo jo?

14 Pë. Unë në Klan Kosova kam punuar për më shumë se katër vite,  
15 kështu që është e natyrshme që kam krijuar edhe raporte  
16 shoqërore.

17 Py. Dhe e kam të drejtë kur them se ke pasur, ke ndërtuar  
18 marrëdhënie pune edhe me kolegë të tjerë po në agjenci të  
19 tjera përveç Klan Kosovës dhe tek inFokusi?

20 Pë. Në Klan Kosova kam qenë gazetar i terrenit ku më -- jam  
21 takuar shpesh me shumë gazetarë dhe raporti me ta ka qenë më  
22 shumë raport profesional sesa raport shoqëror. Kur kam kaluar  
23 në gazetën inFokus kryesisht kam punuar brenda zyrës. Kështu  
24 që në atë kohë nuk është që kam krijuar ndonjë raport  
25 shoqëror me dikën, përveç gazetarëve në inFokus.

1 Py. E kuptoj. Pra, marrëdhënie më të ngushta kishe me kolegët  
2 në Klan Kosova dhe më pak miqësore, po profesionale të themi,  
3 me kolegë të tjerë në organe të tjera të shtypit në Kosovë;  
4 kështu?

5 Pë. E saktë.

6 Py. Faleminderit. Në 7 shtator ke qenë i pranishëm në  
7 konferencën e shtypit në zyrat qendrore të OVL UÇK-së në  
8 cilësinë tënde zyrtare si gazetar; kështu?

9 Pë. Po.

10 Py. Aty kishte dhe gazetarë të tjerë në cilësinë profesionale  
11 si gazetar apo jo?

12 Pë. E saktë.

13 Py. Ju ishit me një koleg tjetër profesional, një kameraman  
14 të inFokusit; kështu?

15 Pë. Po.

16 Py. Dhe lidhur me atë kolegun tjetër, na ke thënë se kolegë  
17 të tjerë -- të kujtohet që kishte kolegë nga organe të tjera  
18 shtypi, Ekonomia online dhe një ekip nga Kosova dot.com;  
19 kështu ka qenë?

20 Pë. Nuk është që i kam njohur si gazetarë, se thashë, tash  
21 kam punuar brenda në zyrë edhe nuk është që i kam njoftë  
22 kështu shumë po i kam njoftur përmes logos që e kanë pasur në  
23 mikrofonat e tyre. Kështu që po, me sa më kujtohet, ka qenë  
24 një ekip i Kosova Press, një ekip i Ekonomia online po ashtu  
25 një ekip i kallxo.com, me sa më kujtohet, përveç të tjerëve.

1 Py. E kuptova. Ai qëllimi që solle me vete atë kameramanin  
2 ishte që të merrte, të filmonte pjesë nga konferenca apo jo,  
3 nga konferenca e shtypit?

4 Pë. Po.

5 Py. Ky kameramani si quhej Mirko Birim - siç e shqipton ky -.

6 Pë. Jo, emri është gabim nuk ka qenë Mirko po ka qenë Mjeku.  
7 Emri është saktë, ndërsa mbiemri është Mjeku.

8 Py. Të kërkoj ndjesë. E shqiptova unë gabim. Pra, kameramani  
9 filmoi pjesë të konferencës për shtyp; kështu?

10 Pë. Po.

11 Py. Ishte dhe një agjenci tjetër që mori pamje filmike dhe  
12 Kosova Press e ka transmetuar; kështu?

13 Pë. Po.

14 Py. Po inFokusi ka transmetuar pjesë filmike nga ajo  
15 konferencë për shtyp?

16 Pë. Nuk më kujtohet saktë pasi -- me sa më kujtohet nuk ka  
17 trasmetuar drejtpërdrejtë, po nuk jam shumë i sigurt. Arsyeja  
18 pse nuk më kujtohet është që pasi jam kthyer në zyrë kam qenë  
19 shumë i zënë me këto punë tjera dhe nuk jam marrë me atë  
20 pjesë.

21 Py. Në intervistën që pate me Prokuroren në 25 gusht, i ke  
22 sugjeruar që disa materiale janë transmetuar në median  
23 sociale; kështu?

24 Pë. Nuk e kuptova. Çfarë sugjerimi kam bërë?

25 Py. Në intervistën që pate me Prokuroren në 25 gusht, ke

1 përmendur se disa materiale janë transmetuar në median

2 sociale; kështu?

3 Pë. Me siguri që po, për arsye që edhe tash shumica e

4 pyetjeve dhe pothuajse krejt dëshmia ime është edhe publike.

5 Janë edhe të publikuara si inFokusit, si dhe mediave tjera.

6 Kështu që i kam thënë që pyetjet që m'i kanë bërë atëherë edhe

7 pyetjet që po më bëhen tash të gjitha përgjigjet janë edhe

8 online.

9 Py. Po kuptoj. Me sa kuptove ti, konferenca e shtypit ishte

10 për Gjykatën Speciale dhe për disa dosje që kishin të bënin me

11 të akuzuarit, kështu është thënë në një prej artikujve. Si

12 gazetar profesionist pse more pjesë në këtë konferencë me një

13 kameraman për ta regjistruar, për ta incizuar dhe për të

14 transmetuar pjesë të kësaj konference?

15 Pë. Këtë vendim nuk e kam marrë unë. Këtë vendim e ka marrë

16 redaksia. Në përgjithësi pasi, siç kam tregu ma herët, gazeta

17 inFokus nuk është një media me shumë gazetarë edhe vendimet që

18 me dal një gazetar edhe një kameraman jashtë zyrës merren prej

19 redaksisë.

20 Py. Po, dhe ti ishe pjesë e këtij ekipit redaktorial o

21 editorial?

22 Pë. Po. Unë në atë kohë kam ushtruar profesionin e gazetarit

23 dhe redaktorit.

24 Py. Po të pyes, tani, si gazetar çfarë interesi kishe ti të

25 merrje pjesë në një konferencë për shtyp që kishte të bënte me

1 disa dosje të Gjykatës Speciale të lidhura me të akuzuarit? A  
2 mund të na thuash diçka për këtë apo jo?

3 Pë. Po sigurisht. Na si media, si ekip redaktorial e kemi veç  
4 një synim, e kemi interesin publik, interesin që qytetarët me  
5 ditë se çka po ndodhë. Edhe interes shumë i madh publik me  
6 siguri që është edhe Gjykata Speciale, po ashtu, janë edhe  
7 Veteranët e UÇK-së. Kështu që një çështje që ka pasur të bëjë  
8 edhe me Veteranët e UÇK-së edhe me Gjykatën Speciale me siguri  
9 që ka enë interes publik, interes që duhet me -- informata që  
10 duhet me i ditë qytetarët.

11 Py. Faleminderit, z. Berisha. Në fund të konferencës, i ke  
12 kërkuar kameramanit të marrë, të filmojë dokumentet, të marrë  
13 pamje të dokumenteve, kështu?

14 Pë. Kameramani në fjalë, është një kameraman me shumë  
15 përvojë, me shumë vite përvojë pune edhe me ma shumë përvojë  
16 sesa unë si gazetar, kështu që, nuk ka pasur nevojë atij me i  
17 thanë me xhiru diçka pasi si çdo kameraman tjetër me përvojë e  
18 din që është e nevojshme me marrë pamje me xhiru.

19 Py. Përsëri dua t'ju siguroj, si Prokurori si unë, nuk  
20 sugjerojmë që ti ose kameramani keni bërë diçka të gabuar për  
21 këtë ju sigurojmë. Thjeshtë duam të shikojmë, të shtjellojmë  
22 gjërat që kanë ndodhur.

23 Pra, kameramani ishte njeri me përvojë dhe filloi të xhironte  
24 dokumentet të filmonte dokumentet dhe ti u pajtove me këtë?

25 Pë. Është kjo është e zakonshme, jo veç në këtë rast, është e

1 zakonshme që në çdo konferencë për shkak që nevojiten pamjet  
2 jo ndoshta diçka specifike. Po çdo konferencë pasi të  
3 përfundon konferenca për media, të gjithë gazetarët marrin  
4 pamje për mes të cilave cilat nevojiten nëse përpunohet  
5 materiali më tutje pas përfundimit të konferencës. Kështu që  
6 kam qenë në rregull me këtë punë se është diçka e zakonshme.  
7 Py. Ashtu është. Dhe ti i dëgjove ato që u thanë në  
8 konferencën e shtypit për dokumentet. Dhe ti dhe gazetarë të  
9 tjerë filluat, siç the, detyrën e të kontrolluarit të  
10 dokumenteve, kameramani që i filmonte, që xhironte gjatë kësaj  
11 kohe. A e dini sesa dokumente keni parë bashkë me kameramanin  
12 përpara sesa të kërkoje t'i merrje dokumentet?

13 Pë. Është e vështirë me dhanë një numër pasi që dokumentet  
14 edhe kanë qenë disi të çorganizuara në atë momentin kur jemi  
15 ofruar pas përfundimit të konferencës edhe ka pasur shumë  
16 gazetarë aty rrethit dhe shumë kameramanë. Kështu që është  
17 problem me dhanë një shifër të saktë ose edhe të përafërt  
18 është problem me thanë.

19 Py. E kuptoj. Mbase nga pikëpamja e kohës, nëse mundesh të na  
20 ndihmosh? Pa qenë i saktë lidhur me numrin e minutave, po a  
21 mund të na thuash sesa kohë vazhdoi kameramani duke i parë  
22 dokumentet përpara se ti të kërkoje a mund të merrje një  
23 kopje?

24 Pë. Ndoshta 10 minuta, po që këto 10 minuta nuk janë komplet,  
25 tuj u nis prej përvojës, këto 10 minuta nuk janë komplet

1 xhirim se ai synimin e ka me marrë prej këndeve të ndryshme.

2 Diçka që kërkon që me qenë sa më profesionale pamjet. kështu

3 që 10 minuta po besoj 10 ose 15, po që e gjithë kjo nuk ka

4 qenë non-stop xhirim.

5 Py. E kuptoj. Bëra një gabim në pyetjen e fundit. Ti nuk

6 kërkove kopjet. Ti kërkove që të marrësh dokumentet kështu?

7 Pë. Unë kërkova, thashë që është problem, se ka shumë

8 dokumente dhe që, nëse muj me pasë ndonjë dokument, me marr se

9 me kqyrë se çka janë, çka është fjala.

10 Py. Në intervistën tënde the që ju drejtove z. Haradinaj, që

11 e pyete, kështu?

12 Pë. Po, në fakt, aty e ceka edhe më herët se ka pasur shumë

13 gazetarë dhe kameramanë rrethit të asaj tavolinës ku kanë qenë

14 dokumentet. Aty kanë qenë edhe personat që e kanë mbajtur

15 konferencën për media afër meje ka qenë z. Nasim Haradinaj

16 edhe un veç kam bërë pyetje nëse muj me marr ndonjë dokument.

17 Pastaj përgjigja ka ardhur prej z. Haradinaj.

18 Py. Është diçka shumë e vogël dhe besoj që nëse mundem do të

19 përfundoj para pushimit. Është diçka e vogël. Por personit të

20 cilit ju iu drejtuat ishte z. Haradinaj lidhur me marrjen e

21 disa dokumenteve kështu?

22 Pë. Me sa më kujtohet unë e kam bërë pyetjen po kam -- është

23 problem pak me shpjegu. Me sa më kujtohet, unë siç thashë, ka

24 pasur shumë njerëz dhe e kam ditë që personat përgjegjës, po

25 them kështu përgjegjës, po të cilët e kanë prezantuar



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 41

1 konferencën për media kanë qenë aty edhe unë e kam ba pyetjen,  
2 veç kam pyet, ajo dihet që unë nuk i kam pyetur gazetarët ose  
3 kameramanët, unë kam pyet personat që kanë prezantuar  
4 konferencën për media. Edhe përgjigja më është dhënë prej z.  
5 Haradinaj.

6 Py. Pra, do kemi pushimin tani z. Berisha.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [E  
8 padëgjueshme].

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të  
11 bëjmë një pushim prej 30 minutash. Do të mblidhemi përsëri në  
12 11.30.

13 --- Pauza fillon në orën 10.57

14 --- Seanca rifillon në orën 11.30

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Sekretare e seancës, a mund të shoqëroni dëshmitarin në sallën  
17 e gjyqit, ju lutem.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Uluni, z.  
20 Berisha.

21 Mirë atëherë, z. Rees. Mund të vijoni me pyetjet.

22 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

23 Py. Në fund të konferencës për shtyp më datën 7, pasi  
24 shpenzuar rreth 10 apo 15 minuta duke këqyrur dokumentet,  
25 ndërkohë që kameramani regjistronte apo xhironte disa prej

1 dokumenteve, juve pyetët në qoftë se mund të merrnit  
2 dokumentet. Pra, në fakt, ju dëshironit të merrnit të gjithë  
3 sasinë e dokumenteve që ishte aty; është kështu?

4 Pë. Nuk kam mëndu që është e mundshme me i marr gjithë sasinë  
5 e dokumenteve, veç kam pyetë se çka mundem me marrë.

6 Py. Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së më 25 gusht, ju  
7 thatë që pasi keni pyetur në qoftë se mund të merrnit  
8 dokumentet, juve ju pyetën në qoftë se doni të merrnit të  
9 gjithë paketën dhe juve jeni përgjigjur si më poshtë:

10 "Në pozitën time, në pozicionin tim si gazetar, përderisa  
11 ishte puna ime kjo, në qoftë se isha i interesuar që t'i  
12 merrja të gjitha dokumentet".

13 Pra, në qoftë se unë e kam të drejtë, në qoftë e kam  
14 kuptuar siç duhet, në qoftë se do të kishit pasur mundësi, ju  
15 do t'i kishit marrë të gjitha dokumentet apo jo?

16 Pë. Po, e saktë.

17 Py. Ju ishit të interesuar që të merrnit dokumentet në  
18 pozicionin tuaj si gazetar. Ju lutem a mund të na shtjelloni  
19 pak më tepër këtë gjë? Se çfarë lloji interesi kishit ju që të  
20 merrnit të gjitha dokumentet?

21 Pë. Siç e shpjegova dhe para pauzës, na fillimisht e kemi pa  
22 si interes i publikut që me raportuar në lidhje me këtë  
23 çështje. Në këtë rast, përderisa ka pasur shumë dokumente edhe  
24 nuk e kemi ditë saktë se çka janë, qëllimi ka qenë që nëse  
25 është e mundshme me i marrë dokumentet dhe me kqyrë se çka

1 mujna me raportu edhe çka është për tu raportu. Kështu që në  
2 mes dy gjerave për ti zgjedhë, me i marrë një pjesë të  
3 dokumenteve ose me i marrë krejt dokumentet, besoj, që secili  
4 gazetar kish preferuar të dytën.

5 Py. Pra, ju dhe kolegu juaj, kameramani, ju thatë që keni  
6 marrë rreth 1000 faqe; kështu?

7 Pë. Është pak problematike me përcaktuar sesa faqe kanë qenë,  
8 po përafërsisht, me atë çka muj unë ndoshta me vlerësuar, kanë  
9 qenë aty dikund aty rreth 1000 faqe, por mundet me qenë numër  
10 tjetër.

11 Py. E kuptoj. Është e vështirë që të thoni faqen ekzakte,  
12 numrin ekzaktë të faqeve. Por, megjithatë, disa dokumente u  
13 lanë aty. Ju morët rreth 1000 faqe dhe i dërguat në zyrën e  
14 gazetës inFokus; kështu është?

15 Pë. E saktë.

16 Py. Dhe u kthyet së bashku me kolegun tënd, me kameramanin,  
17 në zyrë, pra, në gazetën inFokus së bashku me dokumentet?

18 Pë. Po.

19 Py. Në zyrë kur ishit aty, ju më pas i diskutuat dokumentet  
20 me kolegë të tjerë tuaj, me redaktorë të tjerë të gazetës  
21 inFokus; kështu është?

22 Pë. Po, me redaktorët, po jo me gazetarët.

23 Py. A e mbani mend sesa redaktorë ishin? Me sa redaktorë i  
24 keni diskutuar dokumentet ju?

25 Pë. Nëse nuk gaboj, kanë qenë edhe katër të tjerë.

1 Py. Domethënë, keni qenë ju, kameramani dhe katër të tjerë?

2 Pë. Kameramani jo. Kameramani veç nuk ka pasur kurrgjë të bëj  
3 me dokumentet, ai veç ka marrë ato pamjet edhe ka ardhur me mu  
4 deri në zyrë.

5 Py. Në rregull.

6 Py. Tani, le të kalojmë tek numri i kolegëve që ishin te  
7 gazeta inFokus, që kishin qasje në dokumente: Fillimisht ishit  
8 ju edhe kameramani dhe pastaj ishin edhe katër persona të  
9 tjerë në zyrën e inFokusit; këta kishim qasje?

10 Pë. Megjithatë, kameramani nuk ka pasë qasje. Kameramani veç  
11 në fillim i ka xhiruar ato çka kanë qenë në konferencë. Po  
12 pasi i kam marrë dokumentet unë, nuk ka pasur qasje  
13 kameramani.

14 Py. E kuptoj. Por ai ka pasur qasje në të kur i ka xhiruar;  
15 apo jo?

16 Pë. Po, kur i ka xhiru ka qenë aty tek konferenca për media.

17 Py. Do t'ju kërkoj që të shihni një dokument.

18 Z. REES: [Përkthim] Dokumenti ka numrin e identifikimit  
19 081364, që mendoj që është faqja e parë e dokumentit P125.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Është faqja e katërt e këtij  
21 dokumenti, të nderuar Gjykatës.

22 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling. E vlerësoj  
23 ndihmën.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, të  
25 nderuar Gjykatës, përkthimi në gjuhën angleze është dokumenti

1 i identifikuar si P125-ET.2.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
3 a mund ta përsërisni edhe njëherë znj. Sekretare?

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
5 përkthimi në anglisht i këtij dokumenti është dokumenti me  
6 numër P125-ET.2. Numër i caktuar sot paradite.

7 Z. REES: [Përkthim] Jo, përkthimin në anglisht.  
8 Py. Atëherë, këtu shikojmë dokumentet të cilat janë të  
9 shpërndara në një tryezë edhe shikojmë fotografinë e këtyre  
10 dokumenteve; kështu është?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
12 Faleminderit, z. Koci.

13 Z. REES: [Përkthim]  
14 Py. Pra, mund të shikojmë një fotografi në artikullin që  
15 është botuar më datë 7 shtator 2020 dhe shikojmë dokumente të  
16 cilat janë të shpërndara në një pjesë të një tryeze; është  
17 kështu?

18 Pë. [E padëgjueshme].

19 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se do të kalojmë tek faqja  
20 tjetër e këtij artikulli.

21 Py. Përsëri, kemi dokumente të shpërndara në një tryezë. Dhe  
22 kemi një fotografi tjetër në faqen e dytë. Kalojmë më tej  
23 shohim një tjetër fotografi sërish që dëshmon pamje të një  
24 pjesë të dokumenteve; kështu është?

25 Pë. [E padëgjueshme].

1 Py. Kjo tryeza ku gjendet? Ku ndodhet kjo?

2 Pë. A mundet me shpjegu pak zyrën e inFokusit, zyrën e  
3 gazetës inFokus se qysh është për me spjegu edhe këtë punën.  
4 Në rregull.

5 Gazeta inFokus posedon një zyrë të madhe, e cila është  
6 pjesë ku qëndrojnë gazetarët. Pastaj posedon një zyrë të  
7 takimeve ku qëndron edhe kjo tavolina ku janë bërë  
8 fotografitë. Ndërsa në mes tyre qëndron është dhoma e  
9 drejtorit dhe administratës.

10 Këto dokumente, që është bërë fotografia këtu, është në  
11 këtë zyrën e takimeve te ajo tavolina e madhe ku i kemi vendos  
12 edhe kemi qëndruar ne redaktorët, ekipi redaktorial kemi  
13 qëndruar aty brenda.

14 Py. Faleminderit. Artikulli është botuar në orën 14.39. Kjo  
15 fotografi është bërë atë ditë, ndërkohë që dokumentet ishin të  
16 shpërndara në tryezën në zyrën kryesore të inFokusit; apo jo?

17 Pë. Me siguri që atë ditë dhe pse nuk më kujtohet saktë, po  
18 me siguri atë ditë, pasi që veç atë ditë i kemi kqyrë  
19 dokumentet e pastaj kanë qenë të mshefuna, kanë në qenë të  
20 siguruara.

21 Py. Dhe artikulli është botuar më datë 7 shtator. Kështu që  
22 duhet të jetë bërë atë ditë fotografia apo jo?

23 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë tek fillimi, tek  
24 faqja e parë.

25 Py. Kush i ka bërë këto fotografi të dokumenteve që ishin

1 shpërndarë në tryezën e madhe të zyrës kryesore të gazetës

2 inFokus?

3 Pë. Nuk më kujtohet me saktësi, për arsye që fokusi në atë

4 kohë ka qenë se çka përmbajnë dokumentet dhe është vështirë me

5 kujtu se kush i ka fotografuar, për arsye që nuk kam besuar që

6 mundet me ardhë koha edhe me tregu kush i ka fotografuar ato.

7 Py. Dhe në qoftë se ju bëj një kopje përgjigjen e së cilës

8 nuk e dini, ju lutem thoni që nuk e di. Por të paktën a mund

9 të na ndihmoni me këtë: A ishte kameramani që kishte qenë

10 kameramani në konferencën për shtyp apo dikush tjetër që i ka

11 bërë këto fotografi?

12 Pë. Jo, kameramani nuk ka qenë në atë zyrë.

13 Py. Në rregull. Dhe xhirimi i konferencës për shtyp, i

14 dokumenteve të bëra nga kameramani, xhirimi i bërë nga

15 kameramani, çfarë lloj aparature është përdorur për të bërë

16 xhirime dhe për të bërë fotografitë nga kameramani të këtyre

17 dokumenteve?

18 Pë. Nuk më kujtohet e as nuk e di. Edhe s'kam njohuri për atë

19 pjesë. E di që ka qenë kamerë profesionale po çfarë kamere nuk

20 e di.

21 Py. Atëherë ta lëmë mënjanë modelin ose markën e kamerës, a

22 bëhej fjalë për një kamerë e cila është e projektuar për të

23 xhiruar p.sh., filma apo një kamerë më konvencionale e cila

24 mund të bënte edhe fotografi mund të bënte edhe xhirime apo

25 nuk e thoni dot këtë gjë?

1 Pë. Jo, sa e di unë, ka qenë për xhirime jo për fotografi.

2 Py. Dhe do të ketë regjistruar, xhiruar në mënyrë dixhitale,  
3 jo në mënyrë sipas modelit të vjetër, domethënë, filmat sipas  
4 modelit të vjetër; kështu është?

5 Pë. Po, edhe ato i ka xhiruar veç në konferencën për media.

6 Py. Dhe kamera ose aparatura e përdorur për të marrë këto  
7 pamje të dokumenteve, a ishte e njëjta aparaturë që kameramani  
8 ka përdorur në konferencën për shtyp apo ka të ngjarë që të  
9 ketë qenë një tjetër aparaturë apo nuk e thoni dot përgjigjen  
10 e kësaj pyetjeje?

11 Pë. Më fal, nuk e kuptova shumë mirë pyetjen.

12 Py. Pra, kameramani në konferencën për shtyp kishte një  
13 kamerë profesionale. Aparatura e përdorur për të bërë  
14 fotografinë e dokumenteve që ishin shpërndarë në tryezën e  
15 inFokusit, a do të ishte e njëjta aparaturë që kameramani  
16 kishte përdorur më përpara apo ka më shumë të ngjarë që të  
17 kishte qenë një aparaturë tjetër, një kamera tjetër mbase?

18 Pë. Jo, për atë aparaturën që e ka përdorë kameramani është  
19 përgjegjës veç kameramani. Edhe atë, përderisa ai nuk ka qenë  
20 në zyrë, nuk ka qenë as aparatura.

21 Py. Pra, këto imazhe këto fotografitë të bëra nga një  
22 aparaturë e dytë, sërish, a mund të na ndihmoni pak në këtë?  
23 Ju lutem, në qoftë se mundeni. Pra, kanë qenë imazhe dixhitale  
24 apo janë bërë fotografi sipas modelit të vjetër me filma të  
25 kohës së vjetër; a mund ta thoni përgjigjen e kësaj pyetjeje



1 apo jo?

2 Pë. Nuk kena pasur aparatura të vjetra, kështu që nuk ka qenë  
3 e atij lloji.

4 Py. Faleminderit.

5 Z. REES: [Përkthim] A mund të shohim një tjetër  
6 fotografi, një tjetër imazh. Një moment, ju lutem, sa ta gjej.  
7 Është dokumenti me numër identifikimi ERN 102768 ju lutem znj.  
8 Sekretare. Ju lutem, të shikojmë gjysmën e sipërme të  
9 dokumentit.

10 Py. Sa për ta sqaruar, ju thatë që më përpara që të gjitha  
11 këto artikuj janë ende në internet; apo jo? Domethënë, janë  
12 akoma të disponueshëm të botuar në faqen e internetit të  
13 inFokusit; apo jo?

14 Pë. Unë nuk punoj më aty, po me sa e di, nuk është shlyr ai  
15 artikull.

16 Py. Faleminderit. Në fakt, mund të konfirmojë që aty janë.

17 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se mundeni znj. Sekretare,  
18 do ju kërkoja që të shfaqnit dokumentin me numër identifikimi  
19 DHG0270 dhe vendoseni atë përbri dokumentit ose artikullit  
20 botuar nga inFokusi. Ju lutem shfaqeni përbri këtij dokumenti.  
21 Edhe njëherë numri i identifikimit të dokumentit është DHG027  
22 [sipas përkthimit].

23 Py. Atëherë ndalo për një moment, të shohim pjesën e sipërme  
24 të faqes, fotografinë aty në fillim. Pra, mund ta shikoni që  
25 është i njëjti artikull dhe në qoftë se do të shikojmë p.sh,

1 kohën, vulën e kohës të dokumentit me numër identifikimi DHG e  
2 shikoni datën që është 25 tetor 2021, ora 04.38 pasdite.  
3 Domethënë, i njëjti artikull është botuar sërish në faqen e  
4 internetit të inFokusit.

5 Në qoftë se do të shikojmë në fotografinë me ngjyra që  
6 është pak më e qartë në këtë version, pra, që është versioni  
7 në të djathtë të ekranit, mund t'i shikojmë sërish dokumentet.  
8 Domethënë, janë dokumente të cilat janë të shpërndarë nëpër të  
9 gjithë tryezën. Dhe mund të identifikoni të paktën katër  
10 persona këtu në dhomë. Domethënë, në qoftë se do të shikojmë  
11 sipas sahatit, do shohim dikë i cili ka veshur një bluzë me  
12 ngjyrë portokalli; po e sheh? Dikush pastaj që ka një këmishë  
13 të bardhë, mund të shikojmë dorën që e ka mbi tryezë ky  
14 personi. Në qoftë se shikojmë në fund shohim një person tjetër  
15 që i duket vetëm dora dhe duket sikur është edhe një tjetër  
16 person në të majtë. Pra, në pozicionin e orës 9.00 në qoftë se  
17 do të kemi parasysh një orë.

18 A mund t'i shikoni këto z. Berisha? A nuk është kështu?  
19 Atëherë, pra, nuk e dinë qoftë se mund ta konfirmoni se të  
20 gjithë po e shohim këtë fotografi?

21 Pë. [E padëgjueshme].

22 Py. Kjo tryezë a është e njëjta tryezë që e kemi parë në  
23 imazhet në fotografitë e mëparshme po është e ndryshme?

24 Pë. Po, është e njëjta.

25 Py. Pra, është e njëjta tryezë. Mund të shohim këta katër

1 personat. Ça po bëjnë këto katër personat? Ju po këqyrnit

2 dokumentet bashkë?

3 Pë. Po. Ashtu siç e thashë ma herët, kemi qenë ekipi

4 redaktorial që i kemi shikuar dokumentet në këtë zyrë.

5 Py. Dhe në këtë artikull, jo në versionin bardhë e zi në

6 fakt, sepse nuk është shumë i qartë teksti, po në versionin me

7 ngjyra shohim që ky është një dokument i cili është botuar në

8 9 shtator 2020 në orën 21.24. A e dini në qoftë se kjo

9 fotografia e katër personave që shohim, po shikojnë këto

10 dokumente? Pra, domethënë a mund se kur është bërë kjo

11 fotografi?

12 Pë. Jam goxha i sigurt që fotografia është bërë më 7 shtator

13 pasi dokumentet, asnjëherë, në asnjë ditë tjetër, nuk kanë

14 qenë në këtë dhomë, nuk kanë qenë kështu të shpërndara.

15 Py. Duket? Mirë, atëherë a e di ti se kush e ka bërë këtë

16 fotografi?

17 Pë. Jo, nuk më kujtohet.

18 Py. Mund të shohim në dhomë që në tryezë është një telefon

19 dhe nëse do të përdorim sërish sahatin, është thuajse në

20 pozicionin e orës 10.00 telefoni, a e shikoni? Është kështu? E

21 shikoni telefonin?

22 Pë. Po.

23 Py. Dhe duket sikur të paktën ka një tjetër telefon në dhomë

24 në pozicionin e orës 7.00 ose 8.00 në sahatin e orës.

25 Pë. Po.

1 Py. Dhe këto duket se janë telefona smart. Jeni dakord apo  
2 nuk e thoni dot nga çfarë shihni?

3 Pë. Nga kjo çfarë shihet po. Duket se janë telefona smart.

4 Py. Dhe sigurisht të gjitha këto fotografi, të cilat janë  
5 publikisht të disponueshme në faqen e internetit të inFokusit  
6 nga momenti që janë botuar; apo jo?

7 Pë. Më fal?

8 Py. Këto fotografi, që nga momenti që janë hedhur në faqen e  
9 internetit të inFokusit janë plotësisht të disponueshme  
10 publikisht për t'u parë nga gjithkush që është i interesuar  
11 përfshirë këtu p.sh., edhe hetuesit e ZPS-së? Jeni dakord me  
12 këtë?

13 Pë. Po.

14 Py. Pra, juve ja treguat këto dokumente katër kolegëve që  
15 përmendët më sipër. Katër kolegët në imazhin, në pamje në të  
16 majtë edhe në të djathtë në fakt, a janë këta kolegët që ju  
17 thatë që ishin rreth tryezës që po diskutonin këto materialet  
18 në dhomën e madhe apo nuk e thoni dot se kush janë këto katër  
19 kolegë?

20 Pë. Prej kësaj fotografisë nuk po muj me i identifiku, po  
21 megjithatë, sa e di unë, këtu kemi qenë veç ekipi redaktorial.  
22 Kështu e njoh ekipin redaktorial.

23 Py. Pra, ishit pesë juve gjithsej, ti edhe katër të tjerë;  
24 kështu?

25 Pë. Po, besoj që kjo është numri i saktë.

1 Py. Ndoshta e keni të vështirë t'i përgjigjeni pyetjes që do  
2 të bëj tani por pyetja është kjo. A jeni ju njëri prej  
3 personave prej katër personave që tregohet në këtë fotografi  
4 apo jo?

5 Pë. Kam shumë dyshime, unë nuk jam me siguri njëri prej  
6 këtyne dyve që janë në të djathtën time të fotografisë, po kam  
7 dyshime tek personi që duket veç pak në të majtën time, po nuk  
8 jam shumë i sigurt as për këtë.

9 Py. Pra, personi i cili me të dyja duar ka mbajtur ca  
10 dokument në duar në pozicionin e 9.00 tek sahati i orës, mund  
11 të jeni ju ky personi po nuk jeni i sigurt; këtë po thoni?

12 Pë. [E padëgjueshme].

13 Py. A mund të ketë ndodhur që ta keni bërë ju këtë fotografi?

14 Pë. Nuk më kujtohet.

15 Py. Në qoftë se nuk ju kujtohet, na e thoni këtë gjë. Por në  
16 qoftë se ju nuk e mbani mend nëse e keni bërë këtë fotografi  
17 apo jo, domethënë, nuk e di as nëse e ke bërë dhe nuk e di as  
18 nëse nuk e ke bërë; kështu është?

19 Pë. Saktë. Nuk më kujtohet. Nuk e di.

20 Py. Në sfond në tryezë, është një si shkop i bardhë me një  
21 kabllo në fund të saj dhe kablloja është e rrethuar. A mund të  
22 na ndihmosh duke na thënë se çfarë është kjo?

23 Pë. Po, kjo po duket si mbushës i një telefonit.

24 Py. Pra, ju u kthyet tek inFokusi, i ndatë dokumentet me këto  
25 katër kolegë tuajit. Dhe në intervistën e dhënë -- atëherë,

1 nuk është se kishte redaktime apo jo, domethënë, mbi këto  
2 dokumente. Nuk është se betë ndonjë -- nuk kishit bërë akoma  
3 ndonjë redaktim mbi këto dokumente në këtë fazë ku jemi?  
4 Pë. Përveç çdo dokument që e kemi publiku, jemi mundu me u  
5 siguru që mos me dalë asnjë e dhënë që mundet me qenë  
6 konfidenciale ose me identifiku diçka. Këto editimet janë bërë  
7 në mënyrë dixhitale, nuk janë bë në dokumente fizike.

8 Py. Faleminderit. E kuptoj. Dhe do t'i shohim disa prej  
9 dokumentet që keni botuar ju, po ashtu do shikojmë redaktimet,  
10 editimet e bëra. Megjithatë, për t'ju siguruar edhe njëherë  
11 dua t'ju them që as unë, as Prokuroria, nuk sugjeron nuk thotë  
12 nuk mendon që ka ndonjë gjë që nuk shkon.

13 Por dokumentet që keni ndarë me katër kolegët tuaj,  
14 editorët e tjerë, këto janë dokumente siç i keni marrë nga OVL  
15 e UÇK-së?

16 Pë. Po.

17 Py. Një nga gjërat që na the se ishte interesuar në  
18 intervistimin me Prokurorinë më 25 gusht ishte të dije se cili  
19 qe personi që kishte sjellë dokumentet. Sigurisht që nuk ishte  
20 e vetmja gjë që të interesonte, po kjo ishte një nga gjërat që  
21 të interesoj kur pe dokumentet. Vazhdove ta hetoje më tej, ta  
22 hulumtoje më tej këtë çështje apo jo?

23 Pë. Po, jemi marrë me këtë çështje por këtë kohën sa është  
24 fol për këto dokumente. Jemi marrë edhe me këtë çështje.

25 Py. Dua t'ju bëj një pyetje diskrete, në qoftë se mund t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 55

1 përgjigjesh jo, thuaj "jo": Në hetimet tuaja apo hulumtimet  
2 tuaja, e keni identifikuar ndonjëherë personin që i ka  
3 dorëzuar këto dokumente në zyrat e OVL UÇK-së?

4 Pë. Jo, asnjëherë.

5 Py. Ju na thatë që nuk ishit i pranishëm në konferencën e  
6 dytë për media mbajtur në 16 shtator, por se vazhdove të  
7 raportoje për këto ngjarje.

8 Z. REES: [Përkthim] Tani, ju lutem të shohim artikullin  
9 me numër 102766-ET është përkthimi i tij në fakt.

10 Py. Mund të duroni pak, z. Berisha, sa ta gjej referencën në  
11 këtë dokument të madh që kam.

12 Z. REES: [Përkthim] Të shohim faqen 102772 të këtij  
13 dokumenti.

14 Py. Ky është një nga dokumentet që ke identifikuar. Ky është  
15 dokumenti që ke treguar kur fole me Prokuroren në  
16 intervistimin apo ja ke treguar ti Prokurores? Të kujtohet  
17 kjo?

18 Pë. Jo, nuk më kujtohet.

19 Py. Versioni i fotokopjuar i artikullit në të majtë mban  
20 datën dhe është jo i qartë -- data nuk është e qartë nga  
21 mënyra si është fotokopjuar.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Data është e qartë është DHG0279.

23 Z. REES: [Përkthim] Jam shumë mirënjohës z. Halling, për  
24 ndihmën e tij.

25 Pra, ju lutem, të shfaqim në ekran këtë dokument me numër

1 DHG0279, ju lutem.

2 Py. Që ta shohim është i njëjti artikull, që është si ai i  
3 botuar në web site e inFokus, 25 tetor 2021 dhe në fund është  
4 emri i autorit, pra, koha dhe data; kështu?

5 Po kalojmë tek përkthimi tani.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal  
7 dokumentet në ekran janë shënuar me numrin P129 sot në  
8 mëngjes.

9 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

10 Py. Aty shohim se keni raportuar për dy dorëzime në datën 7  
11 shtator dhe më vonë, nëntë ditë më vonë, në 16 shtator,  
12 dorëzimin e paketave të dokumenteve, në mes të artikullit.  
13 Thoni dhe aty shkruani se udhëheqësit e OVL UÇK-së ishin  
14 ankuar se dukej se ishin monitoruar dhe se komunikimet ishin  
15 interceptuar. Dhe se ju keni botuar një artikull të një makine  
16 që ecën me shpejtësi dhe në bazë të kësaj kanë menduar se po i  
17 ndjek.

18 Pë. Po e shoh. E shoh artikullin. Po.

19 Py. Siç thatë në pyetjet që u bënë, të gjitha përmbajtjet e  
20 artikujve që keni botuar ishin të saktë të vërtetë me aq sa ju  
21 keni dijeni; e saktë kjo?

22 Pë. E saktë.

23 Py. T'i kthehemi datës 7 shtator, ne pamë sesi ju dhe ekipi -  
24 - pjesa tjetër e ekipit editorial i vendosët dokumentet në një  
25 tavolinë të madhe dhe i keni parë, i keni hulumtuar këqyrur.



1 Z. REES: [Përkthim] Të shohim dokumentin 081364-ET.

2 Py. Ju keni raportuar atë ditë, apo jo, se:

3 "bashkëpunimi midis hetuesve të specializuar dhe  
4 zyrtarëve serbë ishte i dukshëm në këto materiale".

5 E gjeni këtë pjesë në paragrafin e tretë?

6 Z. REES: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti me  
7 numër P1235.

8 Py. Më falni z. Berisha se e ndërpreva. A mund të na e  
9 shpjegoni se përse raportuat mbi bashkëpunimin midis  
10 Prokurorisë dhe zyrtarëve serbë që ishte i dukshëm nga ato  
11 dokumente?

12 Pë. Sepse, siç tregova dhe ma herët, një pjesë e  
13 konsiderueshme e dokumenteve të cilat i kemi posedu na kanë  
14 qenë korrespondenca të komunikimit në mes të zyrtarëve të Task  
15 Forcës Speciale të Hetimit edhe prokurorëve e zyrtarëve të  
16 tjerë në shtetin e Serbisë.

17 Py. Dhe për mendimin tuaj, pse ishte interesante të  
18 botoheshin këto artikuj, pra, fakti që vihej në dukje  
19 bashkëpunimi midis hetuesve të specializuar dhe dëshmitarëve  
20 serbë dhe zyrtarëve serbë? A mund të na shpjegoni pse?

21 Pë. Po, ky vendim për çdo artikull që është publiku, është  
22 marrë mendimi i të gjithë redaksisë. Kështu që mendimi i jonë  
23 ka qenë që me u publiku, kjo përderisa një gjë e tillë edhe,  
24 pse me e përmend prapë, nuk kemi qenë të sigurt për  
25 autenticitetin dhe konfidencialitetin e dokumenteve një gjë e

1 tillë tek këto korrespondenca nuk ka shkru që është  
2 konfidenciale. Edhe për derisa nuk ka shkru që është  
3 konfidenciale te një pjesë e tyre, kemi raportu për to. Edhe  
4 ka qenë interesi i publikut me ditë se çka ka në ato dokumente  
5 edhe për çka po bëhet fjalë.

6 Py. Faleminderit.

7 Z. REES: [Përkthim] Të shikojmë dokumentin me numër ERN  
8 102780-ET.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është dokumenti me  
10 numër P129.

11 Z. REES: [Përkthim] Në faqen 12780.

12 Py. Kemi përkthimin e një dokumenti, me numër DHG0311, pra,  
13 në anën e majtë, është një dokument i disponueshëm publikisht.

14 Z. REES: [Përkthim] Të përqendrohemi ke koha, pra, koha  
15 që është ora 17.08.

16 Py. Dhe të shohim dhe përkthimin. 7 shtator data. Artikulli i  
17 referohet në rreshtin 8, poshtë, në pjesën kryesore të tekstit  
18 se çfarë përmbajnë ato dosjet e shpërndarë të hënën?

19 "Gazetarët e bordit editorial të inFokus i këqyrën  
20 materialet që i referohen kryesisht bashkëpunimit midis  
21 hetuesve të Task Forcës Hetimore Speciale dhe autoriteteve  
22 serbe".

23 "Dokumentet tregojnë shumë qartë sesi kjo Task Forcë ka  
24 bashkëpunuar me autoritet serbe dhe përmbajnë shkëmbimin e  
25 korrespondencës, letrës".

1 "Sistemi i përdorur këtu kryesisht kërkon që të mbledh të  
2 dhëna, prova, të dhëna nga ish-punonjësit e policisë dhe  
3 shefat e policisë serbe me udhëzim për të gjetur dëshmitarë  
4 dhe për të mbledhur sa më shumë informacion për krimet e  
5 pretenduara".

6 Pra, ky informacion erdhi nga këto dokumente; kështu?

7 Pë. E saktë.

8 Py. Pse keni raportuar konkretisht informacionin që bën fjalë  
9 për kërkesat për të marrë informacion nga punonjësit e  
10 policisë dhe shefat e policisë, pse ishte me interes kjo gjë?  
11 A mund të na e shpjegoni pak më shumë, mund të shtjelloni më  
12 tepër?

13 Pë. Po, këtë pak a shumë e shpjegova dhe ma herët kur tregova  
14 që në këto dokumente kur i kemi këqyrë, ka pasur dyshime edhe  
15 prej anës sonë nëse janë autentike ose konfidenciale. Na jemi  
16 mundu me raportu në lidhje me to pa e thyer konfidencialitetin  
17 e që kemi dyshu nëse është i vërtetë ose nuk është i vërtetë.  
18 Kështu që kjo çështje, tuj i pasë parasysh edhe konferencat  
19 për media që janë bë prej Organizatës së Veteranëve të Luftës,  
20 tuj e pasë parasysh edhe kohën në të cilën janë bërë këto  
21 konferenca, kjo ka qenë një diçka që ju ka interesu qytetarëve  
22 të Kosovës se për çka bëhet fjalë në ato dokumente.

23 Edhe na kemi raportuar tu u mundu mos me e thy  
24 konfidencialitetin që është pretenduar që është në ato  
25 dokumente.

1 Py. E kuptoj këtë, por përsëri, dua t'ju siguroj që as  
2 Prokuroria, as unë nuk themi që keni bërë ndonjë gjë të gabuar  
3 dhe e kuptoj qëndrimin tuaj. S'keni botuar asnjë gjë që ishte  
4 konfidenciale.

5 Dua të të pyes nëse mund ta shtjelloni më tej arsyetimin  
6 tuaj?

7 Z. REES: [Përkthim] Z. Koci, kishit gjë për të thënë?

8 Z. KOCI: [Përkthim] Kam nevojë për dy minuta të  
9 konsultohe me klientin.

10 [Dëshmitari këshillohet me avokatin e tij]

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 Z. REES: [Përkthim]

13 Py. Z. Berisha, a mund të shtjelloni më tej se përse, për  
14 mendimin tuaj, mendoni se do të ishte në interesin e publikut  
15 të mësonin që, domethënë, ndihma vinte kryesisht të mësonin,  
16 të merrnin dëshmi nga policia dhe nga shefat e policisë serbe?

17 Pë. Po, veç nëse më lejohet, se përgjigja e kësaj pyetjeje  
18 ndoshta mundet me qenë pak më e gjatë sesa përgjigjet e tjera.

19 Ne kemi mendu se kjo është me interes për publikun tuj e  
20 pasë parasysh të kaluarën që e ka pasë populli jonë, populli i  
21 Kosovës. Unë ndoshta jam i ri me moshë, por edhe unë e kam  
22 prek pak kohën e luftës. Unë kam qenë gjashtë vjeçar në kohën  
23 e luftës. Gjatë asaj kohe, unë bashkë me familjen teme dhe me  
24 qytetarë tjerë, jemi largu me forcë prej banesës, prej  
25 shtëpisë tonë jemi largu me forcë dhe jemi dërgu, jemi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 61

1 detyruar me udhëtu për në Shqipëri.

2 Unë si një -- kjo çka po them unë është ma e lehta se çka muj  
3 me thënë tjerët. Unë si një gjashtë vjeçar jam detyru me ec  
4 deri në Shqipëri pa bukë, pa ujë edhe forcat serbe kanë vendos  
5 edhe trupa të vdekur në rrugë, ku unë si një fëmijë pesë  
6 vjeçar, gjashtë vjeçar është deshtë me kaluar nëpër ta.

7 Domethënë, kjo është një temë e ndijshme për neve. Është  
8 një temë që shtjellohet çdo ditë te na. Edhe për këtë arsye  
9 kjo ka pasë një -- kemi menduar që kjo ka interes për publikun  
10 me raportuar për këtë çështje.

11 Py. Faleminderit, z. Berisha. Në artikull shohim, që duke  
12 parë përkthimin në anglisht, keni vazhduar të thoni se  
13 artikulli tregon mënyrën e bashkëpunimit midis Task Forcës dhe  
14 autoriteteve serbe. Dhe e thekson sesi ka -- "Si është bërë ky  
15 bashkëpunim". Dhe ju keni shkruar se:

16 "Nga korrespondenca kemi mësuar se roli kryesor është  
17 luajtur nga të gjitha struktura shtetërore serbe të cilat kanë  
18 krijuar grupe pune për të mbledhur fakte lidhur me krimet e  
19 pretenduara për t'ia dhënë Task Forcës".

20 Pra, informacioni dilte nga vetë dokumentet; kështu  
21 ishte?

22 Pë. E saktë.

23 Py. Dhe ju e botuat sapo na shpjeguat në interesin e  
24 publikut?

25 Pë. Po. Se siç e thashë, ka plotë kesi raste dhe njerëz që

1 janë të interesuar me ditë në lidhje me këtë çështje.

2 Py. Pastaj ju vazhdoni, thoni që:

3 "Task Forca ka pasur kontakt kryesisht me Vladimir  
4 Vukcevic ish-kryeprokuror i krimeve të luftës dhe Milovan  
5 Dreniç".

6 A mund të na ndihmoni duke na thënë se përse -- a së pari  
7 ky informacion ishte në dokument?

8 Py. Veç për emrin, nuk e di nëse mu përkthye gabim, është  
9 Milovan Dreçun. Po, këto ishin në dokumente.

10 Py. E kam unë fajin sepse nuk e thashë unë mirë si e  
11 shqiptova unë, ju kërkoj ndjesë. Pra, informacioni doli nga  
12 dokumentet dhe ju e publikuat. A mundet të na e shpjegosh  
13 përsëri se përse, për mendimin tuaj, ishte në interesin e  
14 publikut që ta bënit këtë?

15 Pë. Ishte në interesin e publikut se këta persona janë  
16 zyrtarë të lartë të shtetit të Serbisë edhe këta persona janë  
17 persona që një pjesë e popullit edhe i njeh për shkak të  
18 deklaratave dhe veprimtarive të tyre. Edhe janë persona  
19 publik. Kështu që, përderisa disa persona publikë që nuk kanë  
20 qenë privat janë përmend në ato edhe e kemi pa që është në  
21 interesin e publikut që me i raportuar për ta.

22 Py. Vazhdoni aty thoni që.

23 "Shefat e Task Forcës komunikuan drejtpërdrejtë me z.  
24 Vukçeviç dhe Dreçun dhe shumë nga komunikimet midis tyre  
25 tregonin se shefat e Task Forcës u kërkonin fakte për çështje

1 të ndryshme, për dhënien e dëshmimeve, por dhe kanë kontaktuar  
2 lidhur -- dhe informacione për detaje për masat dhe  
3 intervistat e marra në rastin e shumë njerëzve, njerëzve të  
4 ndryshëm në Serbi".

5 Edhe ky informacion nga dokumentet doli?

6 Pë. Po.

7 Py. A mund të na shpjegoni se përse e botuat këtë informacion  
8 në interesin e publikut?

9 Pë. Titulli i këtij lajmi është që çka përmbajnë mijëra faqe  
10 dosje që ju dorëzuar në OVL UÇK-së. Kështu që kjo ka qenë prej  
11 atyne dokumenteve që i kemi pa, shumica e atyne kanë qenë të  
12 këtij lloji edhe kemi tregu se kjo është çka gjendet aty.

13 Py. Por nuk i publikuat emrat e dëshmitarëve, po shoh në mes  
14 të faqes tani, se shumica e tyre ishin serbë por edhe  
15 shqiptarë, romë dhe ashkali. Kishte dhe emrat e këtyre lloj  
16 dëshmitarëve.

17 A mund të na ndihmoni duke na thënë se përse e keni  
18 botuar këtë pjesë, jo emrat, por se përmendeshin pra, serbë,  
19 romë ashkali dhe shqiptarë?

20 Pë. Se si gazetar edhe si media, mision e ke me raportu për  
21 të vërtetën aq sa e dimë edhe aq sa mundemi me raportu. Kështu  
22 që, kjo ka qenë një e vërtetë që është përmend aty edhe na  
23 jemi mundu me e raportu lidhur me këtë gjë.

24 Py. Dhe ju keni cituar aty pjesë nga dy letra drejtpërdrejtë.  
25 Aty ke një pjesa e tretë, një e treta lartë. Dhe aty thuhet:

1 "Në bazë të koordinimit të vazhdueshëm midis dy zyrave  
2 tona, gjeni ju lutem bashkëngjitur listën e personave që Task  
3 Forca dëshiron t'i intervistojë në të ardhmen. Edhe pse  
4 intervista -- edhe pse adresat e njohura së fundi të persona  
5 në fjalë janë në Kosovë dhe duam që ta ndihmoni ndihmën tuaj  
6 në gjetjen e këtyre personave sepse besohet që kanë marrë  
7 shtetësi serbe".

8 "Gjithashtu, ju lutem na jepni kopje të intervistave që  
9 kanë dhënë këto persona apo deklaratave autoriteteve gjyqësore  
10 serbe" dhe ka mban datën 24 shtator 2014 dhe thuhet nga shefi  
11 i Task Forcës, Kwai Hong Ip drejtuar Vukçeviçit"; kështu?  
12 Pë. Po.

13 Py. Dhe këtë e keni botuar në uebsajtin tuaj. Edhe njëherë, a  
14 mund të shpjegoni se përse e keni publikuar këtë?

15 Pë. Kjo ka qenë deklaratë faktike se i e përmendet në ato  
16 dokumente, përveçse e përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo  
17 deklaratë është vendos këtu për me e dëshmu, për me e vërtetu  
18 ato çka kemi thënë, çka shkruhet edhe ma lartë në tekst në  
19 artikull.

20 Py. Të rrimë, të vazhdojmë të qëndrojmë tek ky tekst. Vazhdon  
21 artikulli:

22 "Pra, lista e dëshmitarëve që kërkohet të intervistohen  
23 që është redaktuar për arsye sigurie".

24 Dhe në një fazë të më vonshme do të shohim edhe vetë  
25 pamjet, fotot. Por ju këtu keni publikuar pjesën kryesore të



1    tekstit, por keni hequr emrat nga dokumenti që u shfaq në  
2    ekran; kështu?

3    Pë.    Po.

4    Py.    Dhe na thatë që kjo u bë në mënyrë dixhitale, pra,  
5    editimi në zyrë; kështu?

6    Pë.    Po.

7    Py.    Dhe se kjo u bë pasi i kishit sjellë dokumentet dhe ja  
8    bëtë të njohura kolegëve të bordit editorial dokumentet?

9    Pë.    Po, secili artikull i publikuar është pasi është  
10    diskutuar me krejt ekipin redaktorial.

11    Py.    Në diskutimet, ky ekipi redaktorial i kishin dokumentet  
12    të paredaktuara, të paedituara. Editimet u bënë më pas kur i  
13    keni publikuar apo jo?

14    Pë.    Na kur kemi vendos çka me publiku, kemi vendos edhe cilat  
15    fotografi me u publiku aty. Edhe pastaj para se me e publiku  
16    artikullin, kemi hy edhe i kemi redaktuar.

17    Py.    Kush i ka bërë redaktimet këtyre pamjeve?

18    Pë.    Ky lloj redaktimi është shumë i lehtë me u bë. Nuk më  
19    kujtohet saktë, nuk kemi person të veçantë që merret me këtë  
20    punë.

21    Py.    Pra, mund ta ketë bërë çdokush që ka qenë i pranishëm,  
22    dua të them çdo gazetar që ka qenë në zyrën e redaktimit. Mund  
23    t'i ketë bërë çdo kush nga ju që ka qenë në zyrë?

24    Pë.    Po. Ajo çka është e sigurt që nuk është bë redaktimi prej  
25    dikujt tjetër që i ka pa këto dokumente.

1 Py. E kuptoj. Artikulli vazhdon me një citim tjetër. Në fund  
2 të faqes shikoni, ju lutem. Aty përmendet një letër nga  
3 Komiteti Parlamentar Serb për Kosovën dhe Metohinë - kërkoj  
4 ndjesë nëse se kam shqiptuar mirë - që i dërgohet Task Forcës  
5 në 17 nëntor 2015. Citoj:

6 "Dëshiroj të informoj Komitetin për Kosovën dhe Metohinë  
7 në takimin e mbajtur në 19 tetor 2015 se është ngritur një  
8 grup pune për të mbledhur fakte dhe të dhëna lidhur me krimet  
9 e kryera kundër anëtarëve të popullsisë serbe dhe komuniteteve  
10 të tjera etnike në Kosovë dhe Metohi. Grupi i punës beson se  
11 do të kontribuojë në punën e suksesshme të Task Forcës".

12 Përse e keni përfshirë këtë citim? A mund të na thoni?

13 Pë. Po. Edhe te kjo ka shumë arsye. Një prej arsyeve është që  
14 secili kosovar që është lind para vitit 1996, po besoj dhe  
15 1995, secili në një farë forme është fakt për ata për krimet  
16 që i ka pasë Serbia në Kosovë. E këtu po thuhet, pavarësisht  
17 që Kosova është shpall shtet i pavarur, këtu po thuhet, po  
18 përmendet prapë, qysh vazhdon me u përmend prej zyrtarëve  
19 serbë "Kosova dhe Metohija", që nuk është term i saktë. Edhe  
20 këtu është përmend, në këto korrespondenca, nga zyrtarët serbë  
21 edhe nuk është shkruar konfidenciale, nëse ish shkruar  
22 konfidenciale ne ishim kujdes që kjo mos me u raportu. Po aty  
23 nuk është shkruar konfidenciale edhe atë me këtë term që nuk  
24 është i drejtë edhe me ato që po mbledhin fakte për krimet e  
25 supozune që i kanë bë shqiptarët, kemi besuar që është në

1 interes të publikut me e publiku.

2 Py. Në rregull z. Berisha. A mund të shohim pak, ju lutem,  
3 dokumentin 801361 deri në dokumentin 081363 që është dokumenti  
4 në origjinal. Dhe shohim gjithashtu edhe versionin e  
5 përkthyer. Mendoj që dokumentet me numër reference janë  
6 0871361 deri në 081362-ET.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,  
8 është dokumenti P125 edhe përkthimi është P125-ET.1.

9 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

10 Py. Duke e marrë jashtë kronologjisë këtë në qoftë se do të  
11 shikojmë dokumentin, artikullin në të majtë, ne shohim që ky  
12 është një dokumenti cili ka të bëjë, domethënë, është dokument  
13 i botuar më datë 7 shtator 2020; është kështu? Dhe është  
14 botuar në orën 15.03.

15 Pë. [E padëgjueshme].

16 Py. Mund ta shohim në mes të faqes, faqes së parë, që shfaqet  
17 fotografia e një letre. A e dini se kur është bërë kjo foto?

18 Pë. Sa e di unë të gjitha fotot e dokumenteve që janë publiku  
19 këtu dhe që janë bërë më 7 shtator, në atë ditë kur i kemi  
20 këqyrë dokumentet.

21 Z. REES: [Përkthim] A mund ta zmadhojmë pak letrën znj.  
22 Sekretare?

23 Py. A e dimë në qoftë se kjo është një fotografi e bërë nga  
24 kameramani në konferencën për shtyp apo është bërë më pas në  
25 zyrat e inFokusit, apo nuk thoni dot as njërin as tjetrën?

1 Pë. Jam goxha i sigurt që është bërë në zyrën e gazetës  
2 inFokus, jo prej kameramanit.  
3 Py. Po nuk jeni i sigurt për faktin se kush e ka bërë  
4 fotografinë apo me çfarë aparati është bërë fotografia. Më pas  
5 është ngarkuar - po, më lejoni të bëj një hap pas. Si  
6 ndërtohen faqet e internetit, si konfigurohen ato dhe kush e  
7 bën këtë punë?

8 Pë. Nuk e kam të qartë pyetjen, më fal.

9 Py. Si gazetar, detyra kryesore juaja është që të shkruani  
10 tekstin e artikujve, apo jo? Dhe të identifikoni gjithashtu se  
11 çfarë fotografish do të përdoren në tekst. Por në momentin kur  
12 është shkruar teksti i artikullit edhe është futur edhe  
13 fotografia dikush duhet të jetë përgjegjës për ta hedhur atë  
14 në faqen e internetit. A na e shpjegon dot, ju lutem, se cili  
15 është ky proces? Domethënë, kush e hedh në faqen e internetit  
16 artikullin edhe kush bën këtë lloj organizimi në gazetë?

17 Pë. Po. Ky është një proces shumë i thjeshtë. Bëhet përmes  
18 një produkti online që thirret WordPress edhe përmes të cilit  
19 funksionojnë uebsajtet. Në WordPress mundën me u publiku  
20 dokument. Aty përmes WordPress publikohen shkrimet, tekstet  
21 edhe fotografitë edhe atë e bën secili gazetar që e shkruan  
22 tekstin e publikon tekstin e vet.

23 Py. Në qoftë se dikush ka bërë një fotografi që një gazetar  
24 dëshiron ta përdorë në një botim, në një artikull online,  
25 personi që ka bërë fotografi duhet që t'ia japë dosjen,

- 1    fotografinë, personit i cili bën ngarkimin e kësaj fotografie  
2    si pjesë e artikullit në faqen e internetit; është kështu?  
3    Pë.    Po.  
4    Py.    Dhe siç e thatë nuk përdorni më filma tradicionalë,  
5    pamjet, fotografitë bëhen në mënyrë dixhitale. Pra, dikush  
6    duhet të kaloj këtë dosjen dixhitale nga personi që ka bërë  
7    fotografinë, që mund ta ketë bërë p.sh., me telefon, me video,  
8    me kamerë, pra, duhet që ta kalojë këtë si dosje tek personi  
9    që është përgjegjës për ta ngarkuar në sistem fotografinë  
10    bashkë me artikullin; kështu?  
11    Pë.    Jo, domosdoshmërisht pasi të gjithë gazetarët dhe  
12    punonjësit e medias kanë qasje në WordPress, në atë produktin  
13    online që e përmenda edhe aty posa publikohet një fotografi,  
14    posa bëhet upload ngarkohet një fotografi. Tek ajo fotografi  
15    kanë qasje edhe persona të tjerë që duan me publiku tekste.  
16    Py.    E kuptoj. Atëherë përpara sesa ta hidhni në internet  
17    dokumentin live, personi që e bën fotografinë duhet ta  
18    ngarkojë atë, ta hedhë atë në një sistem, pra, imazhin dosjen  
19    dhe pastaj çdokush tjetër që është gazetar që ka akses, ka  
20    qasje në këtë sistem, mund ta marrë fotografinë edhe mund ta  
21    vendosë në artikullin e vet dhe pastaj ta ngarkoj artikullin  
22    në faqen e internetit; është kështu?  
23    Pë.    [E padëgjueshme].  
24    Py.    Në tekst, atëherë, mund të shohim që raportuat që keni  
25    thënë që:

1 "Janë kërkuar dokumente për Hashin Thaçin, për Adem  
2 Jasharin, Sami Lushtakun, Rexhep Selimin dhe të tjerët".

3 Dhe thoni më tej:

4 "Që kjo bëhet në kuadrin e Gjykatë Speciale dhe kërkohet  
5 që të pranojë prova, pra, nga Serbia kundër Adem Jasharit,  
6 Hashim Thaçit, Sami Lushtakut, Rexhep Selimit dhe të tjerëve".

7 Është paragrafi i dytë.

8 Atëherë, a mund të na thoni përsëri, ju lutem, se pse  
9 mendonit ju që kjo ishte në interes të publikut për ta botuar?  
10 Pë. Po. Në atëkohë nëse nuk gaboj, është përmend Aktakuza për  
11 në atë kohë presidentin z. Hashim Thaçi edhe për të tjerët, po  
12 asnjëherë nuk është përmend që po kërkohen prova për heroin e  
13 Kosovës Adem Jasharin. Edhe kur i kemi pa këtë ne këto  
14 dokumente, kjo me siguri që ka qenë një interes i publikut që  
15 me ditë, pasi që Adem Jashari në atëkohë ka qenë i vrarë prej  
16 forcave serbe. Edhe që besoj që qytetarët e Kosovës e kishin  
17 pritë që me u mbledhë prova për ata që e kanë vra Adem  
18 Jasharin, jo për Adem Jasharin.

19 Py. Faleminderit. Artikulli vijon më tej, i referohet letrës  
20 së David Schwendiman që i dërgon një letër Vladimir Vukçeviçit  
21 duke e kërkuar informacion nga Serbia. Dhe citoj:

22 "Duke u nisur nga koordinimi i vazhdueshëm i zyrave tona  
23 dhe takimit tonë të mbajtur më 1 qershor 2015, me respekt ju  
24 kërkoj që zyra juaj të na furnizojë me kopje të rasteve që  
25 kanë të bëjnë me terrorizëm nga grupe të organizuar të

1 armatosura të kryera nga shqiptarët e Kosovës në periudhën nga  
2 viti 1981-1999, duke përfshirë veprat penale të kapitullit 15  
3 të Kodit Penal të SFRY-së. Ne kërkojmë dokumentet e mëposhtme:

4 "Padi, gjykime si të instancë së parë dhe të instancës së  
5 dytë, duke përfshirë Gjykatën Supreme".

6 Z. REES: [Përkthim] A mund të shohim gjithashtu edhe  
7 faqen e dytë shumë shkurtimisht, ju lutem?

8 Py. Vazhdojmë më tej sërish duke cituar dokumentin.

9 "Po ashtu kërkojmë që dokumentacioni të lidhet me  
10 çështjen e redaktuar në Gjykatën e Prishtinës kundër personave  
11 Nuredin Lushtaku, Sahit Jashtaku Lushtaku [sipas përkthimit],  
12 Sami Lushtaku, Rexhep Selimi e të tjerë".

13 Dhe këtu mbyllet citimi.

14 Pra, thjeshtë do -- ndaloje një moment këtu. Pra, ju e keni  
15 redaktuar numrin e çështjes së vjetër që keni, që i është  
16 referuar Gjykatës së Distriktit të Prishtinës apo jo?

17 Pë. Po.

18 Py. Ndërkohë që pjesën tjetër e keni cituar direkt nga letra.  
19 A mund të na thoni, ju lutem, se pse në vlerësimin tuaj, sipas  
20 mendimit tuaj, ishte e rëndësishme që të citohej kjo pjesë e  
21 letrës dhe pse mendoni që kjo ishte enë interes të publikut?

22 Pë. Po këtë veç muj me vazhdu atë që e thashë ma herët. Adem  
23 Jashari me mbi 50 anëtarë të familjes, tuj përfshi edhe fëmijë  
24 të vogël, është masakru prej forcave serbe. Edhe na presim si  
25 qytetarë, tash jo si gazetar, presim që me u gjetë edhe me u

1 mbledhë fakte për ata që i kanë masakru edhe fëmijët. E nuk  
2 kemi pritë -- ka qenë e çuditshme dhe si gazetarë kemi mëndu  
3 që është në interes të publikut me u raportu se, pse po  
4 kërkohen fakte për Adem Jasharin ku edhe ma herët shkruhet aty  
5 përmendet terrorizmi në grupet e organizune e të armatosuna.

6 Z. REES: [Përkthim] Të shohim pak fotografinë e  
7 dokumentit. Ndoshta ta zvogëlojmë pak, znj. Sekretare, nëse  
8 është e mundur. Faleminderit.

9 Py. Mund të shohim që kjo është një fotografi, pra, shohim që  
10 dokumenti ka logon në fillim fare SITF, e shohim këtë? Dhe  
11 këtë logo ju nuk e keni redaktuar, nuk e keni edituar apo jo?  
12 Pë. Jo.

13 Py. Ju kërkoh ndjesë në qoftë se e bëra pyetjen përpara.  
14 Pyetja është kjo: Nuk patë ndonjë arsye që pse ta hiqnit logon  
15 e SITF nga ky dokument apo jo?

16 Pë. Jo, nuk pamë arsye si ekip redaktorial, nuk pamë arsye me  
17 e heqë këtë se kjo ka qenë, s'e di qysh me quajt agjenci,  
18 organizatë, nuk po e di qysh me e quajt dhe ka qenë [e]  
19 njohur. Nuk ka qenë një agjenci sekrete. Ka qenë një  
20 organizatë e njohur edhe kemi pa që duhet me tregu se kush e  
21 prej kujna janë ba këto letra. Prej kujna është dyshuar që  
22 janë ba këto letra.

23 Se, po e cekim prapë, kemi pasë dyshime edhe për  
24 autenticitetin edhe për konfidencialitetin.

25 Py. Atëherë shohim që ka një redaktim elektronik të bërë tek



1 rreshti i parë, në fillim të dokumentit, pa na dhënë hollësi a  
2 e mbani mend se çfarë shprehte, çfarë ishte ky rreshti?

3 Pë. Rreshtin e parë nuk e mbaj mend, ndërsa këto dy tjerat e  
4 redaktuara janë -- është numri i rastit.

5 Py. Po. Atëherë kemi redaktimin e numrit të çështjes dhe  
6 numrin të një çështjeje të vjetër që është e përmendur në trup  
7 të artikullit. Edhe kjo është fshirë është e redaktuar; apo  
8 jo? Në kohën kur është bërë kjo fotografi këto redakte nuk  
9 është se kanë qenë tek dokumenti. I keni bërë jua apo jo?

10 Pë. Po, po. Këto janë bërë në formë dixhitale.

11 Py. Pra kushdo që i ka bërë këto redakte i takon që ka  
12 pasur dokumentin e plotë ky personi përpara, pastaj ka bërë  
13 këto redaktimet, fshirjet edhe pastaj e ka ngarkuar në sistem,  
14 kështu është apo jo? Pra, kjo është një foto e cila është  
15 ngarkuar në sistem përpara sesa të bëheshin redaktimet, këto  
16 fshirjet apo fshirjet janë bërë më mbrapa?

17 Pë. Jo, sepse sistemi e ka një sasi të kufizuara të  
18 fotografive dhe të materialit që mundet me posedu. Kështu që  
19 kujdesemi aty mos me publiku, mos me upload-u materiale të  
20 panevojshme. Aty i ngarkojmë veç materialet që kanë me u  
21 publiku në artikull, në këtë rast, materialet e redaktune.

22 Py. Pra, përpara sesa të bëheshin redaktimet mbi dokumentin,  
23 në çfarë formati ruhej kjo dosja? Domethënë, nuk e di, ruhej  
24 në një USB, ruhej në kompjuter? Domethënë, ku ruhej, ku ruhen  
25 këto lloj informacionesh përpara sesa të bëhen redaktimet?

1 Pë. Kryesisht kur ka këso dokumente që shihet nevoja për me u  
2 redaktuar, kryesisht, por jo gjithmonë, i bën gazetari që e  
3 publikon tekstin. E njofton redaksinë, ekipin redaktorial, e  
4 njofton kur e merr dokumentin, kur e redakton edhe e njofton  
5 kur e shlyen dokumentin e paredaktuar. Kështu që kjo bahet prej  
6 gazetarit në shumicën e rasteve, po nuk ka ndonjë mënyrë të  
7 caktuar. Ose e merr me USB ose përmes -- e dërgon në rrjetin e  
8 tij social si mesazh.

9 Py. Kur e ke fjalën për mesazhe e ke fjalën për email, postë  
10 elektronike ose ndoshta mesazhe në tekst, ndonjë lloj tjetër  
11 mesazhi që vihet bashkëlidhur dokumentit për çfarë e keni  
12 fjalën specifikisht?

13 Pë. Jo, se hap më i shpejtë për me u bë kjo, është që, p.sh.,  
14 në rrjetin e tij social i shkruan mesazh vetes edhe ja dërgon  
15 fotografinë. Puna që me pasur qasje veç ai person jo me ja  
16 dërgu dikujt tjetër.

17 Py. Të kuptoj. A mund të shohim ,ju lutem, emailin e parë që  
18 i keni dërguar ZPS-së pas botimit të këtyre dy artikujve.

19 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që bëhet fjalë për dokumentin  
20 me numër reference P98.1, me ERN 091909 deri në 091917. Pra,  
21 ky është i gjithë dokumenti, ndërkohë që specifikisht do të  
22 shikojë faqet nga 091915 e në vijim. Faleminderit.

23 Py. Atëherë, pas botimit të këtyre dy artikujve, ju i dërguat  
24 një email Cristopher Bennett që punon për ZPS-në. Dhe është  
25 përgjegjës për pyetjet e publikut, pra, për t'iu përgjigjur

1 pyetjeve të publikut; është e saktë kjo me aq sa dini ju apo  
2 jo?

3 Pë. Po, është e saktë.

4 Py. Ju thatë që keni hartuar këtë email dhe përpara sesa ta  
5 dërgonit, kolegët e tu redaktorë i hodhën një sy këtij email,  
6 kështu ishte?

7 Pë. E saktë.

8 Py. A e dini nëse u bë ndonjë ndryshim pasi u diskutua me  
9 ekipin e redaktorëve apo nuk e mbani mend?

10 Pë. Po është një farë -- nuk e mbaj mend saktësisht, po është  
11 një farë rregulli, që e përdorim gjithmonë, pasi redaktohet  
12 prej dikujt tjetër që është në pozitë më lartë ose e njëjtë me  
13 ty në pozitë menaxhuese, ajo ndryshohet pak për arsye që me  
14 qenë sa më mirë e përpiluar.

15 Py. Si rregull i përgjithshëm ju nuk e dini në qoftë se janë  
16 bërë ndryshime pas draftit fillestar tuajit të propozuar pasi  
17 kolegët i kanë hedhur një sy email, apo jo?

18 Pë. Saktësisht nuk muj me dhanë përgjigje, po besoj shumë që  
19 është ndryshuar.

20 Py. E mbani mend se në çfarë mënyre mund të jetë ndryshuar  
21 apo jo?

22 Pë. Jo.

23 Py. Por në kohën kur u dërgua email, të pesë anëtarët e  
24 bordit redaktues ishin të kënaqur me përmbajtjen e tij apo jo?

25 Pë. Po.

1 Py. Ju tek subjekti shkruani: Pyetje nga gazeta inFokus  
2 shkruani:

3 "I dashur, z. Bennett,

4 Sot në Kosovë, një person i panjohur i dorëzoi mijëra  
5 fletë dokumentesh organizatës së OVL UÇK-së".

6 Më pas përmendni një përshkrim të përmbajtjes pjesërisht  
7 dhe shtetësinë ose etnicitetin e dëshmitarëve.

8 "Dhe kërkoni në qoftë se jeni në dijeni të rrjedhjes së  
9 këtij informacioni dhe pyesni në fund në qoftë se ju po hetoni  
10 rrjedhjen e dokumenteve.

11 "Dhe çfarë do të ndodhë në qoftë se këto dokumente të  
12 paredaktuara do të botohen nga media".

13 Sërisht edhe dua ta theksojë që nuk po ju kritikoj, as unë  
14 dhe ZPS-ja tha që s'keni bërë asgjë gabim, por thjesht dua të  
15 sqarojë nja dy tre çështje.

16 Së pari, përgjigja që keni marrë për këtë email të  
17 dërguar, pra, nuk ju dha asnjë koment lidhur me email që  
18 kishin dërguar ju apo jo?

19 Pë. Po më është kthyer një përgjigje që as nuk është pohuar  
20 as nuk është mohuar.

21 Z. REES: [Përkthim] Nëse do ta mbajmë këtë dokument në  
22 ekran ndoshta duke e futur -- duke e vënë në të majtë të  
23 dokumentit, ndërkohë që në anën tjetër të vendosim, të shfaqim  
24 dokumentin që ka numrin e referimit 102766 deri në 102780-ET,  
25 të kalojmë tek faqja 102777 e këtij dokumenti.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 77

1 Py. Mund të shohim që në trupin e artikullit në të djathtë,  
2 që është botuar pak më vonë të njëjtën ditë, e vetmja  
3 përgjigje e ZPS-së, siç cilësohet, është -- ju keni cituar:

4 "Faleminderit, për komunikimin Zyra e Prokurorisë së  
5 Specializuar nuk do të komentojë". Dhe mbyllet citimi.

6 Pra, sipas artikullit tuaj kjo ishte përgjigja e shkurtër  
7 e dhënë nga ZPS-ja; apo jo?

8 Pë. [E padëgjueshme].

9 Z. REES: [Përkthim] A është një moment i përshtatshëm,  
10 të nderuar Gjykatës, për të bërë pushimin e drekës tani.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

12 Faleminderit, z. Rees.

13 Znj. Sekretare, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin të dalë  
14 nga sallë.

15 Z. Berisha, ju lutem kthehuni sërish në sallë në orën 14.  
16 30 për të vijuar me dëshminë tuaj. Ju lutem, mos flisni me  
17 askënd tjetër përveçse me avokatin tuaj gjatë pushimit lidhur  
18 me dëshminë. E kuptoni?

19 DËSHMITARI: Faleminderit, Shkëlqesia juaj.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
22 pushim deri në orën 14.30.

23 --- Pauza fillon në orën 12.59

24 --- Seanca rifillon në orën 14.29

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 78

1 Sekretare, silleni ju lutem dëshmitarin në sallën e gjyqit.

2 Z. Rees, a mund të na jepni një ide sesa kohë do t'ju  
3 duhet derisa të mbaroni?

4 Z. REES: [Përkthim] [Mikrofoni i paaktivizuar].

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Gjysmë  
6 ore? OK. Në rregull.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Shumë shkurt.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
9 është i mbyllur]

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.

12 Berisha, do të vijojmë me Pyetjet e Mbrojtjes. Z Rees vazhdon  
13 me pyetjet. Mbase mund t'ju bëjnë pyetje dhe të tjerët.

14 Z. Rees, keni fjalën.

15 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

16 Py. Pra, folëm për emailin e parë që i dërguat ZPS-së dhe  
17 përgjigjen, që nuk e kemi këtu por ti e ke cituar në një  
18 artikull, për të cilin ZPS-ja nuk komentojë. Në pyetjet që  
19 bëmë përpara pamë se ju vazhduat ndërkohë të bënit, të  
20 shtypnit ose të botonit artikuj të tjerrë duke përfshirë --

21 Z. REES: [Përkthim] Zonja Sekretare, të shfaqim në ekran  
22 dokumentin me numër ERN 102766 deri në 102780-ET që në ekran  
23 ka numrin 102767.

24 Py. Ishte ky është një artikull tjetër publikuar prej jush.

25 Juve jeni autori duket aty. Dhe tani bëhet fjalë për datën 9

1 shtator, pra, dita e dytë pas datës ku u mbajt konferenca e  
2 parë për median. Dhe ju keni shkruar një artikull ku thoni se  
3 EULEX-i tha se nuk kishte bërë asgjë me marrjen e dosjeve të  
4 fshehta nga UÇK OVL-ja.

5 Pra, ju kishit informacion se EULEX-i kishte thënë që  
6 s'kishte luajtur asnjë rol në mënyrën sesi kishin arritur këto  
7 dosje në OVL UÇK; kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. Por siç shohim më pas në tekst, ZPS-ja nuk ka pranuar të  
10 komentojë dhe se kur keni shkruar ju artikullin, pra, në orën  
11 11.56 në 9 shtator prapë s'kishin komentuar; kështu?

12 Pë. Po, prapë s'kanë komentu.

13 Py. Po atë ditë më vonë keni dërguar një email tjetër.

14 Z. REES: [Përkthim] Që ka numrin 091917.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,  
16 është komenti me numër P98 MGI.

17 Z. REES: [Përkthim]

18 Py. E shohim se në 9 shtator në 15.57 prapë i keni dërguar  
19 një email Christopher Bennett. Dhe keni thënë tek paragrafi i  
20 tretë i këtij emaili se po e vini në dijeni ZPS-në se kishit  
21 një kopje të dokumenteve, kështu ka qenë?

22 Pë. Po.

23 Py. Pra, nuk e thatë në emailin e parë këtë gjë por e keni  
24 thënë në emailin e dytë dhe keni thënë, se kishte shumë media  
25 që i kishin kërkuar dokumentet. Dhe kishit parasysh shumë

1 kolegë nga media u kishin kërkuar t'i shihnin këto dokumente  
2 që i kishit ju; kështu ka qenë?

3 Pë. E saktë.

4 Py. Edhe pse në emailin tuaj të 7 shtatorit nuk kishit thënë  
5 se kishit kopje të dokumenteve, nuk e bëtë sepse donit të  
6 fshihnit diçka sepse në artikujt që keni shkruar që kishte  
7 botuar atë ditë inFokusi e bëni të qartë këtë gjë?

8 Pë. Ne, në fillim, i kemi dërguar menjëherë email Zyrës së  
9 Prokurorit të Specializuar për me pyetur për dokumente. Po ne  
10 në të njëjtën ditë kur kemi publiku dokumentet, kemi tregu që  
11 e kemi kopjen. Kështu që nuk ka pasë kurrgjë për me fsheh.  
12 Qëllimi i medias para ka qenë veç me e ditë nëse janë në  
13 dijeni për ato dokumente edhe se çka është puna e tyre  
14 dokumenteve.

15 Py. I kemi emailt, nuk besoj se kemi nevojë që t'i shohim  
16 përsëri.

17 Ju thatë se shumë organe të medias i kërkonin dokumentet.  
18 A i mbani mend se cilët koleg apo organe të medias nëse kishin  
19 folur me ju për këtë gjë apo nëse kishit folur ju me ata për  
20 këtë gjë?

21 Pë. Jo, veç në këtë rast. Ndoshta duhet me e shpjegu pak më  
22 detajisht. Jo veç në këtë rast po gjithmonë kur një media ka  
23 material që nuk kanë mediat tjera, atëherë ekziston mundësia  
24 me ndodhë bashkëpunimi me e shpërnda me të tjerët.

25 Po zakonisht, për këto çështje, pyetet personi më i lartë



1 në hierarkinë e medias. Nuk marrin mendim gazetarët ose  
2 redaktorët në këtë rast. Edhe ne kemi diskutuar kur i kemi  
3 marrë mediat me ekipin redaktorial të gazetës inFokus edhe  
4 kemi ardhur në përfundim që mos me i shpërnda këto dokumente  
5 me kurrkënd.

6 Kështu që, te unë, nuk më kujtohet që ka pasë ndonjë  
7 kërkesë për me i marrë mediat -- për me i marrë dokumentet  
8 prej mediave tjera. Po këto kërkesa kanë shkuar te personat që  
9 kanë qenë në hierarki ma lart se unë.

10 Py. E kuptoj. Pra, ju morët dijeni se kolegë tuaj në ekipin  
11 editorial kishin marrë kërkesa nga agjencitë e tjera. Por ju  
12 vetë nuk mbani mend të keni marrë ndonjë kërkesë të tillë, apo  
13 jo?

14 Pë. Nuk më kujtohet, për shkak që kam qenë shumë i angazhuar  
15 tuj u marrë me këto dokumente dhe, në fakt, telefonit nuk i  
16 jam përgjigj as kur më kanë thirrë personat e familjes.

17 Py. Dhe më vonë atë ditë të kontaktuan dy hetues të Zyrës së  
18 Prokurorisë; kështu?

19 Pë. Nuk jam i sigurt nëse ka qenë ma vonë atë ditë ose ditën  
20 e nesërme, po, megjithatë, në atë periudhë, po, më kanë  
21 kontaktuar.

22 Py. Dhe këta dy hetuesit erdhën në zyrat e inFokusit?

23 Pë. Po.

24 Py. Kemi një kopje këtu që quhet si dokumenti i dorëzimit.

25 Z. REES: [Përkthim] Është në faqen 078569. Më duket se ka

1 numrin P100, besoj.

2 Py. E keni parë përpara këtë dokument, përpara se të fillonit  
3 të jepnit dëshmi? Sepse ka firmën tënde në fund?

4 Pë. Po, unë e kam nënshkruar këtë dokument.

5 Py. Nga ky dokument shohim të jetë regjistruar si përmbajtje  
6 se i referohet "Dokumenteve të OVL UÇK-së"?

7 Pë. Po.

8 Py. Pra, hetuesit morën dokumente nga OVL UÇK-ja por nuk  
9 morën ndonjë të dhënë elektronike apo ndonjë USB apo ndonjë  
10 kamera, apo diçka të tillë?

11 Pë. Jo. hetuesit i kanë marrë dokumentet që kanë qenë ato që  
12 i kemi pasur ne dosjen, dosjen komplet.

13 Py. Nuk pyetën për ndonjë të dhënë apo ndonjë mjet  
14 elektronik. Donin vetëm dokumentet e shkruara?

15 Pë. Sa më kujtohet, nuk kanë pyetur për dokumente  
16 elektronike.

17 Py. Në pyetjet që ju bëri Prokuroria ju pyetën nëse ndonjë  
18 dokument mund të ishte shtuar apo hequr gjatë ditëve që  
19 dokumentet mbaheshin në zyrë dhe ju thatë, që me sa dini "jo".

20 Por është e drejtë, siç keni thënë në intervistën e 25  
21 gushtit 2020 [siç] dhënë Prokurorisë, se në atë intervistë  
22 keni thënë, nuk ndenjët 24 orë në zyrë, në zyrën e inFokusit,  
23 sigurisht? Ju kujtohet që e keni thënë këtë në intervistë?

24 Pë. Po.

25 Py. Pra, ju thatë që mesa kishit ju dijeni nuk ishin bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 83

1 kopje të tjera, por se nuk mund, ta përjashtonit mundësinë për  
2 shkak se nuk keni ndenjur në zyrë 24 orë; kështu?

3 Pë. E saktë.

4 Py. Edhe kjo vlen edhe për përgjigjen që keni dhënë ndaj  
5 pyetjes nëse është bërë ndonjë kopje. Dhe se me sa dinit, nuk  
6 janë bërë kopje, por se nuk keni ndenjur në zyrë 24 orë,  
7 kështu që nuk mund ta përjashtoni këtë mundësi. A pajtoheni me  
8 këtë?

9 Pë. E saktë.

10 Py. Dhe pasi ishin larguar hetuesit, mund të themi se  
11 inFokusi vazhdojë të botonte artikuj për këtë temë duke  
12 përfshirë, po të shohim tani vetë artikullin me numër ERN  
13 0102768.

14 Z. REES: [Përkthim] Të shohim, ju lutem, versionin  
15 DHG0270.

16 Faleminderit, zonja Sekretare.

17 Py. Në versionin që është akoma online, 25 tetor 2021, shohim  
18 datën dhe kohën, që nuk shikohet, nuk dallohet qartë nga kopja  
19 këtu, shohim se artikulli është botuar 24 orë pas, në 9  
20 shtator, pra, mbasi u larguan ata apo ata ishin ende aty  
21 hetuesit.

22 Pë. Jo teksti në fjalë është publiku pasi janë larguar  
23 hetuesit.

24 Py. Prapë shohim aty -- po e përsëris, nuk ju kritikojmë që e  
25 keni bërë këtë, po shohim se pasi ata janë larguar keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 84

1 publikuar pamje të disa prej dokumenteve, përfshirë një  
2 dokument të madh kësaj here dhe shohim në tavolinë dokumentet  
3 të vendosura aty lart te pamja lart dhe një dokument pastaj në  
4 këtë artikull.

5 Z. REES: [Përkthim] Dhe pastaj, përsëri, të kthehemi ju  
6 lutem tek 102778 në anën e majtë me numër DHG297.

7 Py. Edhe njëherë, është i njëjti artikull, ai që keni shkruar  
8 dhe është ende në internet dhe nën foton është koha kur është  
9 botuar, 17.21 dhe kësaj here në 16 shtator. Dhe përsëri, një  
10 riprodhim i pamjeve të dokumenteve që ishin mbi tavolinë.

11 Z. REES: [Përkthim] Të kthehemi përsëri - sepse harrova  
12 të flas për diçka - dokumenti 102780. Janë geramat shumë të  
13 vogla të vështira për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar por  
14 shohim që ka numrin DHG0305.

15 Py. Është i njëjti artikull me ngjyra që gjendet përsëri deri  
16 në 25 tetor 2021. Në titull shohim se ka poshtë titullit është  
17 një pamje që është tregon katër dokumente; dakord?

18 Pë. Po.

19 Py. Po të vazhdojmë më poshtë tek të dy dokumentet shohim  
20 se...

21 Z. REES: [Përkthim] Dhe një çikë në krahun e majtë më  
22 poshtë ndaloni aty. Aty shohim se në këtë artikull dhe pak  
23 uleni atë versionin bardhë e zi në anën e majtë, ju lutem.

24 Py. Aty shohim se në artikull kishte një riprodhim pa  
25 redaktim të një letre që ka lartë atë shenjën SITF dhe është

1 vendosur dhe fjala "inFokus" lart po jo në tekst; dakord jeni  
2 me këtë?

3 Pë. Po.

4 Py. I drejtohet Zyrës së Prokurorisë së Krimeve të Luftës

5 Vladimir Vukçeviç:

6 "I dashur z. Vukçeviç,

7 "Kërkesë për koordinim numër 63

8 "Sipas në bazë të bashkëpunimit tonë gjeni listën e  
9 personave që Task Forca e BE-së Speciale Hetimore SITF kërkon  
10 të intervistojë në të ardhshmen e ardhme. Edhe pse adresat e  
11 njohura të fundit të tyre - ju kërkoj ndjesë përkthyesve se po  
12 lexoj shumë shpejt, po e filloj edhe njëherë paragrafin duke  
13 lexuar më ngadalë.

14 "Edhe pse adresat e fundit të njohura të personave në  
15 fjalë ndodhen në Kosovë do të isha mirënjohës në qoftë se zyra  
16 juaj do të na jepte adresat e tanishme, numrat e telefonit dhe  
17 çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë për të gjetur  
18 personat e emëruar në listën e bashkëngjitur sepse mendohet se  
19 kanë kërkuar leje banimi apo shtetësinë serbe.

20 "Për më tepër kërkoj kopje të të gjitha deklaratave të më  
21 mëparshme të dhënë nga këta individë autoriteteve gjyqësore  
22 dhe policore serbe.

23 "Pres me kënaqësi të vazhdojmë bashkëpunimin tonë.

24 "Singerisht ..."

25 Dhe pastaj është firma, nënshkrimi i Kwai Hong Ip, që

1 ishte Prokuror kryesor në detyrë.

2 A mund të thoni se pse për mendimin tuaj, ishte në  
3 interesin e publikut ta bënit këtë gjë, ta botonit, domethënë?  
4 Pë. E para, ishte për me tregu atë çka e kemi thanë edhe në  
5 tekst; që kemi tregu, që ka pasë korrespondenca të këtij lloji  
6 në mes të Task Forcës Speciale të Hetimit edhe me zyrtarët  
7 serbë. Pra, kjo ka qenë për me e dëshmu atë, me dëshmu me  
8 fotografi atë çka e kemi thënë edhe shkruar në tekst.

9 Py. Dhe ju e përcaktuat -- i dhatë përgjigjet më herët lidhur  
10 me bashkëpunimin midis SITF dhe autoriteteve serbe. Dhe letra  
11 në fund i referohet një shtojce në kllapa që thotë  
12 [KONFIDENCIALE] Lista e dëshmitarëve që mban datën 24 shtator  
13 2014."

14 Por ju nuk e keni bashkangjitur listën aty në artikull  
15 apo jo?

16 Pë. Jo, nuk e kemi publiku.

17 Py. Nga kjo që shohim letra nuk pretendon se është  
18 konfidenciale, por konfidenciale është lista që përmendet në  
19 të.

20 Z. REES: [Përkthim] Po të vazhdojmë më poshtë, ta ulim  
21 më poshtë në ekran të dy versionet. Faqen tjetër në të  
22 djathtë. Dhe, ju lutem, zmadhoheni pak pamjen në fillim edhe  
23 në anën e majtë gjithashtu.

24 Py. Pra, është i njëjti dokument. Nuk është i qartë me  
25 versionin me germa të vogla të prodhuara gjatë intervistës. Po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 87

1 në krahun e djathtë në versionin që gjendet në internet akoma,  
2 siç tha, mund të shohim pamjen apo imazhin e një dokumenti  
3 tjetër me logon SITF në krye; apo jo?

4 Pë. Po.

5 Py. Në anën e djathtë ka "Republika e Serbisë, Prokuroria e  
6 krimeve të Luftës". Dhe lexon:

7 "I dashur z. Vukçeviç,

8 "Kërkesë për koordinim për bashkërendim numër 24.

9 "Në bazë të bashkëpunimit të vazhdueshëm midis zyrës sonë  
10 Task Forca Speciale e BE-së TFHS-së kërkon ndihmën tuaj për të  
11 na dhënë hollësi të detaje të personave që listohen më poshtë.  
12 Bazuar në informacionin më të fundit të gjithë këta individë  
13 banojnë aktualisht në Kosovë; por gjatë tre viteve të fundit  
14 kanë dhënë informacion zyrtarëve të kësaj zyre [e  
15 pakuptueshme] - ka tre të MUP-it.

16 Ka tre rreshta - Dushan Dragoviç -. Ka shtatë kolona dhe  
17 ato që shkruhen aty nuk i ka zënë fjala "inFokus" nuk  
18 dallohen?

19 Pë. Po përveç fjalës "inFokus" jemi kujdes që ato me qenë dhe  
20 të editume edhe ma shumë, që mos me u vrejtë çka të shkruame.

21 Py. Përpara se të vazhdojmë me pjesën e mbetur të këtij  
22 dokumenti, sikurse pamë, keni përmendur këto individë, [që] i  
23 ka dhënë informacion zyrtarëve të MUP-it gjatë tre viteve të  
24 kaluara Dushan Drakoviçi në Jagodin. A mund të na thoni se  
25 përse keni raportuar për faktin që këto persona të palistuar,

1 të paemëruar aty i kanë dhënë informacion Dushan Dragoviçit në  
2 Jagodinë?

3 Pë. Po, kjo është vendos prej redaksisë që me u publiku  
4 kështu e redaktuar për një arsye që, e para, mos me u publiku  
5 emrat edhe informatat që janë të këtyre personave këtu. Edhe e  
6 dyta, që me tregu me dëshmu atë çka e kemi shkruar nëpër  
7 tekste.

8 Py. Unë përmenda Dushan Dragoviçin. A mund të na ndihmonit se  
9 pse ishte në interesin e publikut për ta publikuar një  
10 informacion të tillë lidhur me Dushan Dragoviçin?

11 Pë. Emrin e Dushan Dragoviçit, nuk është se e kam ndi  
12 ndonjëherë ma herët. Nuk e njoh se kush është ky. Megjithatë  
13 është e njohur publikisht që edhe pas shpalljes së pavarësisë  
14 së Kosovës, pjesëtarët e MUP-it serb vazhdojnë me qenë aktivë  
15 në Kosovë. Kështu që në mënyrë ilegale sigurisht. Kështu që  
16 kjo ka qenë diçka që ka qenë në interes të publikut me u  
17 tregu.

18 Py. Faleminderit, Z. Berisha.

19 Z. REES: [Përkthim] Tani ta ulim më poshtë faqen të  
20 kalojmë tek pamja tjetër.

21 Py. Aty shohim -- nuk është shumë e qartë po duket sikur  
22 vazhdon ajo tabela, që ishte më lart ku janë hequr janë  
23 redaktuar, pra, përmbajtja.

24 Z. REES: [Përkthim] Pastaj të vazhdojmë më poshtë tek  
25 faqja e fundit dhe të kalojmë te faqja tjetër.



1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo që kemi në ekran  
2 është faqja e fundit.

3 Z. REES: [Përkthim] Po kontrolloj për diçka.

4 Py. A e mbani mend se në përkthimin e këtij artikulli pamë që  
5 ishte një citim aty, nga një letër drejtuar Komitetit  
6 Parlamentar të Serbisë për Kosovën e Metohinë dërguar Task  
7 Forcës në 15 shtator 2015. E mbani mend që e thamë këtë  
8 përpara dreke?

9 Pë. Po.

10 Py. Në fakt, në vetë artikull, ishte riprodhuar e tërë letra  
11 që mund ta shohim në uebsajt, në 25 tetor 2021 në krahun e  
12 djathtë DHG0308; apo jo?

13 Pë. Më fal, nëse mundesh edhe njëherë?

14 Py. Në artikullin që u botua me titull "Çfarë përmbajnë ato  
15 mijëra faqe që janë dhënë Gjykatës Speciale" në fund të  
16 artikullit, ju keni cituar dhe keni riprodhuar letrën nga  
17 Komiteti Parlamentar Serb dërguar Task Forcës në 17 nëntor  
18 2015; a ka qenë kështu?

19 Pë. Po.

20 Py. Dhe mund ta shohim këtë letër të treguar plotësisht.  
21 Domethënë, është akoma në artikullin në faqen e internetit?  
22 Është si DHG0308.

23 Pë. [E padëgjueshme].

24 Py. Mund të shohim që nuk janë bërë redaktime, ndryshime  
25 fshirje këtu.

1 Z. REES: [Përkthim] Atëherë, në qoftë se do të shikojmë  
2 dokumentin me numër identifikimi DHG03014, është e njëjta  
3 faqe. Pra, ky është një version edhe më i qartë.  
4 Py. Është dokumenti i plotë. Dua t'ju pyes në qoftë se ky  
5 është dokumenti që keni cituar në fund të artikullit, që është  
6 dokumenti që u përmend nga z. Milovan Dreçoviç [sipas  
7 përkthimit]. Është ky dokumenti apo jo?  
8 Pë. Ka mundësi që është ky, po nuk jam shumë i sigurt, nëse e  
9 kemi cituar saktësisht këtë dokument. Nuk më kujtohet nëse ka  
10 qenë saktësisht ky dokument që është cituar.

11 Py. Në qoftë se do të shohim përkthimin e artikullit.

12 Z. REES: [Përkthim] Që është në të majtë, që është  
13 dokumenti me numër identifikimi 102766 deri në 102700.

14 Py. Pra, mund të shohim se letra në vetvete është në gjuhën  
15 angleze; apo s'është kështu? Shikoni letrën në të djathtë  
16 është e shkruar në anglisht kjo letër, apo jo?

17 Pë. Po.

18 Py. Dhe sigurisht në artikullin tuaj, i takon që përmbajtja e  
19 letrës të jetë përkthyer në shqip dhe më pas është përkthyer  
20 nga shqipja në gjuhën angleze për arsye të këtij procesi  
21 gjyqësor që është dokumenti në të majtë. Pra, megjithëse  
22 fjalët nuk përkojnë 100 për qind me fjalët në anglisht.

23 Megjithatë mund të shikohet që data është 17 nëntori, e  
24 sheh, 2015? A e shikon dot letrën, ju lutem? Letrën e datës 17  
25 nëntor 2015, e sheh?

1 Pë. [E padëgjueshme].

2 Py. Atëherë, në qoftë se do ta ulim më poshtë përkthimin në  
3 anglisht të artikullit në shqip, atëherë do të shikojmë  
4 referencën në fund të faqes më datë 17 nëntor 2015?

5 Pë. [E padëgjueshme].

6 Py. Në qoftë se do të ndjekim përkthimin e versionit në  
7 shqip, unë në fakt do të lexoj nga origjinali në anglisht.

8 Pra, thuhet që:

9 "Duhet t informojë që Komiteti për Metohinë dhe Kosovën  
10 në takimin e vet më datë 19 tetor 2015 ka miratuar një vendim,  
11 për mbledhjen e fakteve dhe provave në kuadrin e një grupi  
12 pune për të hedhur dritë mbi krimet e kryera kundër anëtarëve  
13 të popullsisë serbe dhe komuniteteve të tjera që jetojnë në  
14 Kosovë dhe në Metohi. Grupi i punës mendon që kjo mund të  
15 kontribuojë për punën e suksesshme të grupit të Task Forcës  
16 Hetimore Speciale dhe pret për bashkëpunimin e saj në të  
17 ardhmen.

18 "Gjithashtu, ne besojmë që do të krijojmë marrëdhënie të  
19 suksesshme dhe bashkëpunim të frytshëm me synimin kryesor që  
20 të nxirren në pah krimet të cilat janë kryer nga të  
21 ashtuquajturit UÇK. Ju lutem, gjeni bashkëlidhur vendimin që  
22 krijon grupin e punës.

23 "Në fund është kryetari i grupit të punës Milovan  
24 Dreçaun. Pra, kjo është letra që i është referuar artikulli  
25 juaj dhe që ju e keni menduar që është në interes të publikut

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Cadman

Faqe 92

1 që ta botoni këtë letër; a nuk është kështu?

2 Pë. [E padëgjueshme].

3 Py. Faleminderit, Z. Berisha.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.

5 Cadman, fjala për ju për të bërë pyetje për dëshmitarin.

6 Pyetje të palës tjetër nga z. Cadman:

7 Py. Z. Berisha, mirëdita.

8 Pë. Mirëdita.

9 Py. Së pari, siç e keni dëgjuar nga Prokuroria dhe nga z.

10 Rees, dua të them që asgjë që them unë nuk duhet të

11 interpretohet në asnjë lloj mënyre që sugjeron ndonjë gjë që

12 ju nuk e keni bërë mirë në punën tuaj. Kështu që nuk duhet të

13 jeni të shqetësuar në asnjë mënyrë lidhur me ato çfarë do të

14 them unë.

15 Kam vërejtur që ju thatë që ju nuk jeni të lumtur që të

16 jeni këtu. Edhe unë në pozicionin tim si avokat i z. Haradinaj

17 do t'ju bëj disa pyetje dhe do të kërkoj disa sqarime shtesë.

18 Ju thatë se jeni informuar për konferencën e shtypit në

19 mëngjesin e datës 7 shtator. Thatë gjithashtu, që kur arritët

20 keni qenë një ndër të parët gazetar që keni arritur në

21 konferencën për shtyp. Është e saktë kjo?

22 Pë. Po, është e saktë.

23 Py. Dëgjuam sesi ju keni qenë i pranishëm gjatë gjithë

24 konferencës për shtyp së bashku me kameramanin i cili ka

25 xhiruar aktivitetin?

1 Pë. [E padëgjueshme].

2 Py. Ju thatë se në përfundim të konferencës për shtyp juve u  
3 afruat në tryezën ku ishin dokumentet dhe konfirmuat që kishte  
4 disa njerëz aty; a është kështu?

5 Pë. Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,  
7 ju lutem, vendosni diçka në fund të fjalisë për ta bërë më të  
8 qartë që po bëni një pyetje për dëshmitarin.

9 Z. CADMAN: [Përkthim]

10 Py. Ndërkohë që ju u afruat tavolinës, ju kërkuat të merrnit  
11 disa prej këtyre dokumenteve dhe ju thatë që kërkuat që të  
12 merrnit të gjithë paketën, a është kështu?

13 Pë. Unë e kërkoja, nuk përcaktova sasinë e sa dokumente me i  
14 marrë, veç thashë, a mundem me i pasë disa dokumente që me e  
15 këqyrë se për çka bëhet fjalë.

16 Py. Dhe ju konfirmuat se morët një numër të konsiderueshëm të  
17 atyre dokumenteve. Ndërkohë që specifikuat që nuk e mbani mend  
18 faqen e saktë të këtyre dokumenteve, por thatë ishin pak a  
19 shumë 1000 faqe; a nuk është kështu apo jo?

20 Pë. E saktë.

21 Py. A është e saktë që në momentin kur i keni marrë këto  
22 dokumente kapasë edhe gazetarë të tjerë përveç jush të  
23 pranishëm aty?

24 Pë. Po. Ka pasë edhe tjerë.

25 Py. Mendoj se sugjeruat se ka pasur pak a shumë ose rreth 10

1 gazetarë të pranishëm aty?

2 Pë. Po, ashtu ka qenë, për afërsisht.

3 Py. Kur kërkuat apo kur morët një kopje të atyre dokumenteve,  
4 kishte diskutim ndërmjet gazetarëve të tjerë sepse edhe ata  
5 dëshironin të merrnin kopje të këtyre dokumenteve; a nuk është  
6 kështu?

7 Pë. Po. Pak a shumë kam dëgjuara që ka pasë edhe diskutime të  
8 tilla.

9 Py. Dhe ty të thanë në atë fazë, se sigurisht në OVL të UÇK-  
10 së ata nuk do të bënë kopje të këtyre dokumenteve për juve; a  
11 është kështu?

12 Pë. Më është thënë që gjatë kohës që i kanë posedur  
13 dokumentet ka qenë një kohë e shkurtër prej momentit kur i  
14 kanë marrë dokumentet deri në thirrjen e konferencës dhe nuk  
15 kanë pasë kohë me ba shumë kopje dokumenteve.

16 Py. Dhe nuk kishte ndonjë sugjerim në atë kohë që ata do të  
17 bënë ndonjë kopje të dokumenteve për juve në atë pikë të  
18 caktuar kohe apo jo?

19 Pë. Jo, nuk kam dëgjuar që dikush ka pasë me ba kopje tjera.

20 Py. Pra, kur i morët ju dokumentet, ishte bërë e qartë se në  
21 qoftë se gazetarët e tjerë do të donin të merrnin kopje të  
22 tjera të këtyre dokumenteve, këto kopje do t'i merrnin nga ju  
23 apo jo?

24 Pë. Më është thënë që nëse kërkohen dokumente prej meje,  
25 atëherë mundësisht me i shpërndarë edhe me gazetarët tjerë.

1 Py. Pasi i morët ato dokumente, ju thatë, që për shkak të  
2 madhësisë së këtyre dokumenteve, kërkuat që ato t'i fusnit në  
3 një çantë, a nuk është kështu?

4 Pë. Po, e saktë. Në një qese, diçka që me i mbajtëa.

5 Py. Deri në atë pikë ose të paktën në asnjë fazë të caktuar  
6 gjatë kohës që ti ishe i pranishëm në OVL atë ditë, a të ka  
7 dhënë ndonjë njeri ndonjë udhëzim lidhur me çfarë duhet të  
8 bëje me këto dokumente?

9 Pë. Udhëzim nuk ka pasë, përveç asaj që më është thënë: Nëse  
10 kërkojnë dokumente prej mediave të tjera, atëherë mundësisht  
11 me bashkëpunuar.

12 Py. Më pas juve qëndruat për një kohë të shkurtër tek  
13 kafeneja, në afërsi të OVL UÇK-së, përpara sesa të shkonit dhe  
14 t'i dërgonit dokumentet në zyrën tuaj; është e saktë kjo?

15 Pë. Po.

16 Py. Dhe sërish gjatë kohës që ishit në kafene, siç dëgjuam,  
17 juve nuk ju është dhënë ndonjë udhëzim lidhur me atë se çfarë  
18 duhet të bëni?

19 Pë. Jo, nuk ka pasë asnjë udhëzim.

20 Py. Në një pikë të caktuar, më vonë gjatë asaj dite, siç  
21 dëgjuam, ju keni kontaktuar me ZPS-në me kërkesën që ata të  
22 konfirmonin autenticitetin dhe konfidencialitetin e këtyre  
23 dokumenteve?

24 Pë. Po, i kemi kontaktuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar  
25 ku i kemi pyetur në lidhje me këto dokumente.

1 Py. Më lejoni t'i kthehem dhe njëherë mbrapsht idesë që  
2 kisha. Pra, ju nuk morët ndonjë përgjigje lidhur me pyetjen që  
3 ju kishit bërë atyre apo jo?

4 Pë. Përgjigje më është kthyer nga z. Christopher Bennett, po  
5 ka qenë: Nuk mund t'i komentojmë këto gjëra.

6 Py. Dhe ju më pas shkruat sërish, tani më datën 9 shtator  
7 duke i informuar që ju keni një kopje të këtyre dokumenteve  
8 dhe që organe të tjera të medias dëshironin të kishin këto  
9 dokumente; a nuk është kështu?

10 Pë. E saktë.

11 Py. Gjithashtu na thatë sot që pas këtij këmbimi juve u morët  
12 në telefon nga dikush. Thatë që nuk e mbani mend saktësisht se  
13 kur morët në telefon por thatë që ZPS-ja ju mori në telefon  
14 dhe ju tha që do të merrte dikush tjetër më vonë në telefon  
15 për të kontaktuar lidhur me këtë çështje, kështu është?

16 Pë. Po.

17 Py. Por pas kësaj telefonate askush nuk kontaktoi me ty deri  
18 në tetorin - më falni - gushtin e këtij viti?

19 Pë. Jo, në atë moment më kanë kontaktuar pastaj hetueset e  
20 Zyrës së Prokurorit të Specializuar që kanë ardhur edhe i kanë  
21 marrë dokumentet.

22 Py. Kjo ka ndodhur më 9 shtator. Pak më përpara thatë që nuk  
23 jemi të sigurt për datën ekzakte por që ka qenë pasi keni  
24 dërguar emailin në shtator?

25 Pë. Po.



1 Py. Në mënyrë që ta kuptoj saktë, është bërë një tjetër  
2 telefonatë pas kësaj?

3 Pë. Po. Pasi i kanë marrë dokumentet hetuesit që, nuk e mbaj  
4 mend kohën, nuk më kujtohet saktë se çfarë dite ose kur ka  
5 qenë, po pastaj prapë kam marrë një telefonatë nga Zyra e  
6 Prokurorit të Specializuar edhe ku më është kërkuar që me e  
7 pasë një takim.

8 Py. Siç e thatë pak më parë, nuk ka pasur një telefonatë  
9 tjetër pasuese, pra, pas kësaj telefonate?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund ta  
11 caktojme pak më shumë saktësisht periudhën e kohës për të  
12 cilën flasim këtu?

13 Z. CADMAN: [Përkthim]

14 Py. Sa për qartësim, z. Berisha, pas datës 9 shtator ju jeni  
15 kontaktuar me telefon, siç na thatë, nga ZPS-ja. A e mbani  
16 mend se kur ka ndodhur kjo?

17 Pë. Jo, nuk e mbaj mend. Nuk e mbaj mend datën.

18 Py. A ka ndodhur brenda pak ditësh pas datës 9?

19 Pë. Me sa më kujtohet kanë kaluar dhe javë. Po prapë po e  
20 them nuk mundet me ndryshu data për arsye që nuk jam i sigurt.  
21 E kam problem me e kujtu.

22 Py. Në rregull. Pra, ka mundësi që disa javë pasi jeni takuar  
23 me hetuesit më datën 9 shtator, ju keni marrë një bisedë  
24 telefonike nga ZPS-ja dhe tani po konfirmoni ose më saktë a  
25 mund të na konfirmoni që ju nuk keni marrë një telefonatë

1 tjetër nga ZPS-ja deri në gusht 2021?

2 Pë. Jo, ka pasë telefonatë tjetër në këtë periudhë.

3 Py. Në cilën periudhë, z. Berisha?

4 Pë. Në këtë periudhën prej 9 shtatorit deri në gusht 2021, ka  
5 pasë edhe një telefonatë tjetër nga Zyra e Prokurorit të  
6 Specializuar.

7 Py. Pra, ke marrë dy telefonata të ndryshme?

8 Pë. Nëse muj me sqaru pak ma detajisht. Fillimisht, më kanë  
9 kontaktuar prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar ku më kanë  
10 kërkuar që me më kontakti disa hetues edhe ata me i marrë  
11 dokumentet. Pas kësaj, që nuk e di saktë sa kohë ka shku, më  
12 kanë kontaktuar prapë prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar  
13 edhe më kanë kërkuar që me u taku, me bisedu në lidhje me këtë  
14 rast, rastin e dokumenteve.

15 Ditët që m'i patën përcaktuar se kur me u taku, unë nuk  
16 kam pasë mundësi, për shkak që kam qenë pushim, nëse nuk  
17 gaboj, por e kemi lanë gjatë një vikendi që me më kontaktuar  
18 prapë. Po nuk ka pasë më kontakt prej tyre edhe nuk më kanë  
19 kontaktuar më e nuk jemi taku. Nuk kam pasë kontakt nga Zyra e  
20 Prokurorit të Specializuar pas kësaj thirrje deri në kohën kur  
21 më kanë thirrë për me u intervistë në Kosovë në gusht.

22 Py. Deri në gusht të këtij viti?

23 Pë. [E padëgjueshme].

24 Py. A të është dhënë ndonjëherë ndonjë shpjegim se, pse  
25 kishte kaq shumë vonesë nga kontakti i parë domethënë nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Berisha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Cadman

Faqe 99

1 telefonata e dytë që keni marrë deri në kontaktin apo

2 telefonatën që keni marrë në gusht të këtij viti?

3 Pë. Jo, as nuk më dhënë ai sqarim, po as nuk kam kërkuar

4 sqarime. Nuk më ka shkuar mendja me kërku sqarim.

5 Py. Z. Berisha, ju jam shumë mirënjohës për kohën tuaj. Nuk

6 kam py etje të tjera për juve. Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit, z. Cadman.

9 Prokuroria?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera. Po

11 thjesht kemi një propozim për Trupin Gjykses.

12 Gjatë ekzaminimit apo marrjes në pyetje të z. Gucati,

13 janë përdorur dy dokumente me numër identifikimi DHG. Dhe ato

14 në fakt kanë marrë emër kanë marrë domethënë numër si P129,

15 kështu që nuk shikoj ndonjë arsye që pse mos të përcaktohen si

16 prova materiale duke vendosur nga një pikë 1 dhe pikë 2

17 secilës prej tyre?

18 Z. REES: [Përkthim] Jemi dakord, nuk kemi gjë për të

19 kundërshtuar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull

21 atëherë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Kemi dokumentin e parë i cili do

23 të marrë kodin e ri P129.1 dhe DHG 0311 do të marrë numrin

24 përkatës me pikë 2. Këto do të jenë dokumentet me ERN do të

25 jenë dokumente publike. Ndërkohë që dokumentet e para të

1 këtyre provave materiale do të jenë konfidenciale për arsye të  
2 cilat janë shpjeguar më përpara.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

4 Z. REES: [Përkthim] Për thjeshtësi, do të doja që të  
5 them që kemi ngarkuar në listën e prezantimit ose të  
6 dokumenteve tona është një riprodhim i provave materiale të  
7 cilat i prezantoi z. Halling. Fillon me DHG0215 dhe shkon deri  
8 në DHG0317. Do sugjeroja që këtë ta regjistrojmë si një provë  
9 materiale me një numër të vetëm, pra, si një dokument të  
10 vetëm.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për këtë.  
12 Ndërkohë që provat materiale të kombinuara duhet të jenë  
13 konfidenciale për arsye të cilat janë shpjeguar më përpara.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të paktën  
15 për tani.

16 Z. REES: [Përkthim] Të paktën për tani.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë  
18 doni që t'i japim një numër tërësisht të ri? Të mos e kemi si  
19 shtojcë? Apo thjeshtë një numër të ri?

20 Cili do ishte ky numër?

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është numri 1D2.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja  
24 Sekretare, mund ta shoqërosh z. Berisha të dalë nga salla.

25 Z. Berisha, faleminderit që ishit me juve [sipas

1 përkthimit], faleminderit që i dhatë përgjigje pyetjeve tona  
2 dhe ju urojmë gjithë të mirat.

3 DËSHMITARI: Shkëlqesia juaj, zotërinj Gjykatës nëse mu  
4 kish leju edhe diçka në fund me shtu sa i përket interesit  
5 publik të qytetarëve edhe vendimit tonë për me i publiku disa  
6 prej lajmeve aty.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëshmia  
8 juaj ka përfunduar, pyetjet që ju bënë morën përgjigje prej  
9 jush. Kështu faleminderit shumë z. Berisha.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 [Dëshmitari largohet]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
13 Mattraux ka një pyetje për juve, zoti Rees.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
15 Smith.

16 Zoti Rees, i ndoqa pyetjet që bëtë juve për dëshmitarin  
17 dhe e kuptoj pjesën që klienti juaj bëri atë çfarë bëri në  
18 ndjekje të interesit publik; a nuk është kështu?

19 Z. REES: [Përkthim] Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj gjithashtu që  
21 është pjesë e çështjes suaj që klienti juaj është nxitur, për  
22 kryerjen e veprës -- për kryerjen e asaj çfarë ka bërë. Pyetja  
23 është thjeshtë sa për të kuptuar se cili është pozicioni juaj  
24 lidhur me këtë çështje.

25 A po thoni ju se dy propozimet për të vepruar në interes

1 të publikut dhe sugjerimi i nxitjes për veprën nuk janë në  
2 përputhje me njëra-tjetrën apo pozicioni ose qëndrimi juaj  
3 është që këto argumente të parashtrohen në alternativë,  
4 domethënë, në qoftë se Trupi Gjykses nuk e pranon pretendimin  
5 për nxitje për kryerjen e veprës, atëherë ne mund t'i kthehemi  
6 çështjes për interesin e publikut? A mund ta sqarosh pak të  
7 lutem se cili është pozicioni juaj?

8 Z. REES: [Përkthim] Pozicioni ynë është që z. Gucati ka  
9 bërë atë çfarë ka bërë për interesin e publikut. Ne do të  
10 parashtrojmë se sjelljet dhe veprimet e tij nuk çojnë në vepër  
11 penale.

12 Në qoftë se Trupi Gjykses është kundër nesh në këtë  
13 pozicion, atëherë ne do të themi që ai ka vepruar duke ndjekur  
14 nxitjen nga të tjerët. Dhe, siç e kemi ngritur, kjo është një  
15 çështje për sa i takon kësaj procedure në kuptimin që kush  
16 është nxitur. Dhe sa i takon kësaj çështje, do të ketë nxitje  
17 të policisë edhe do të duhet që të shqyrtojmë se, kush është  
18 përfshirë në këtë nxitje për të kryer krimin.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se unë e kuptoj  
20 siç duhet, pra, neve së pari do të duhet të shqyrtojmë  
21 çështjen e interesit të publikut dhe pastaj pretendimin për  
22 nxitje për kryerjen e krimit?

23 Z. REES: [Përkthim] Ne do të parashtrojmë që në  
24 instancën e parë Trupi Gjykses të shqyrtojë se çfarë veprimesh  
25 ka ndërmarrë zoti Gucati dhe në qoftë se këto veprime çojnë në

1 vepre penale apo jo. Ne do të parashtrojmë që veprimet e tij  
2 nuk çojnë në vepër penale dhe pjesë e këtyre parashtrimeve do  
3 të përfshijnë përmendjen e interesit të publikut.

4 Në qoftë se Trupi Gjykues është kundra nesh dhe, në qoftë  
5 se do të marrë vendime për të kundërtën, atëherë ne do t'i  
6 kërkojmë Trupit Gjykues sepse ka vepruar ai, jo sa i takon  
7 pistës së interesit të publikut por ajo çfarë ka ndodhur  
8 përpara kësaj. Dhe do të ndjekim shtegun e nxitjes për  
9 kryerjen e veprës. Atëherë, pra, pyetja për sa i takon nxitjes  
10 së policisë është se kush ka qenë i përfshirë në një nxitje të  
11 tillë.

12 Kjo është mënyra sesi e shikojmë ne këtë gjë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

14 Nuk e di nëse z. Cadman mund të na thoni në qoftë se  
15 pozicioni është i tillë apo jo?

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Do thosha që është identik i  
17 njëjti pozicion si i z. Rees.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do  
20 fillojmë të gjithë në 09.30. Do të trajtojmë nesër çështjen e  
21 dokumenteve me kodin MFI dhe pas kësaj do të kemi mundësi që  
22 të thërrasim dëshmitarin e radhës.

23 Z. REES: [Përkthim] Duke parë ditën e nesërme, kemi edhe  
24 çështjen e nxjerrjes së materialeve që kemi ngritur.

25 Kur kemi pasur shkëmbim me ZPS-së dje, duke respektuar

1 procedurat që kemi ndjekur deri tani, duke u përpjekur që të  
2 zgjidhim çështjen ndërmjet palëve, pra, ju kemi treguar ZPS-së  
3 se pavarësisht se ne jemi mohuar nga njoftimi sipas rregullit  
4 102(3), që ka të bëjë me materialet e rëndësishme të lidhura  
5 me tri çështje të reja. Unë nuk është se po them që këto janë  
6 të reja, megjithatë duke pasur parasysh përgatitjen për  
7 seancën pasardhëse për dëshmitarin W04842.

8 Edhe ne ja kemi bërë këto kërkesa që kanë të bëjnë me  
9 përgatitjen për materialin përgatitës, le të themi, për  
10 seancën e radhës mbështetur në rregullin 102(3) si çështje  
11 urgjence. Dhe ne kërkuam që për aq sa ekzistojnë këto  
12 dokumente të na jepen, por në qoftë se ZPS-ja kundërshton mbi  
13 bazën e materialitetit, pra, mbi bazën e rregullit 102(3)  
14 duhet që të na bëjnë njoftimet mbështetur në rregullin 102(3)  
15 dhe t'i drejtohet Trupit Gjykses për këtë gjë.

16 Ne nuk kemi pasur një përgjigje në përputhje me  
17 rregulloren, pra, por e vetmja përgjigje që kemi marrë është  
18 që ata nuk do të nxjerrin materialet. Por ata nuk kanë thënë  
19 në qoftë se e kundërshtojnë materialitetin ose në qoftë se do  
20 t'i drejtohen Trupit gjykses lidhur me këtë çështje.

21 Në këtë rast, neve na rezulton që ata ose të bëjnë  
22 nxjerrjen e dokumentit mbi bazën e rregullit 102(3) ose të  
23 bëjnë njoftimin sipas rregullit përkatës, pra, për t'ju  
24 drejtuar trupit Gjykses. Ne kërkojmë që këto çështje të  
25 trajtohen përpara sesa të fillojmë me dëshmitarin tjetër.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
2 rregull. Faleminderit.

3 ZPS-ja keni ndonjë përgjigje lidhur me këtë?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, disa prej  
5 argumenteve tona i paraqitëm në mëngjes, vlerësimi ynë është  
6 se kjo është e parakohshme dhe tepër e gjerë.

7 Mocioni i minutës së fundit, mocione të minutës së fundit  
8 i këtij lloji për të cilat po flasim, meqë ra fjala, siç është  
9 kërkesa për të parashtruar deklaratë zyrtare pas seancave  
10 përgatitore të dëshmitarit që u hodh poshtë sot në mëngjes,  
11 këto lloj mocionesh e bëjnë procedurën e përgatitjes së  
12 dëshmitarit të miratuar nga Trupi Gjykes të papërdorshme në  
13 praktikë. Ne këtë drejtim vëmë në dukje se burimi më i mirë  
14 për të cilat Mbrojtja kërkon të bëj pyetjet e saj është  
15 deklarata.

16 Z. REES: [Përkthim] Mund të përgjigjem shkurtimisht?

17 Propozimi që thuhet, se kërkesa jonë është jo në kohën e  
18 duhur, më lë pa frymë, të them të vërtetën. Ne jemi në  
19 rrethana kur ZPS-ja jo më larg se fillimi i këtij viti hodhi  
20 poshtë përpjekje për të hyrë në diskutim, diskutim i arsyeshëm  
21 lidhur me fushëveprimin e çështjes së paraqitur nga ZPS-ja,  
22 përfshirë, p.sh., sesi ata kërkojnë të provojnë elementet që  
23 dëshirojnë të nxjerrin -- për të cilët dëshirojnë të marrin  
24 prova nga ky dëshmitar tani, ata me këmbëngulje refuzuan të  
25 angazhoheshin në diskutime të tilla dhe e bënë të qartë këtë

1 gjë. Dhe ne për këtë do të mbështetemi në Njoftime Zyrtare të  
2 dëshmitarit të cilat do t'i nxjerrim dhe pranimet të tyre me  
3 vonesë përmes një mocioni të bërë Trupit Gjykses, i cili na u  
4 refuzua në 29 shtator.

5 Në këtë refuzim, Trupi Gjykses ngriti -- tha se kjo nuk  
6 dëmtonte thirrjen e ZPS-së, për një qëllim të kufizuar, një  
7 dëshmitar që kishte njohuri të kufizuara dhe kishte shkruar  
8 disa prej këto shënime të kontaktit me idenë për të dhënë  
9 dëshmi që kishin të bënin me këto njoftime për dëshmitarët.

10 Më pas, ne morëm indikacion në listën e provave materiale  
11 që ZPS-ja do të përdorë me këtë dëshmitar referenca ndaj shumë  
12 njoftimeve të tjera të cilat ata kërkojnë të nxjerrin nga ky  
13 dëshmitar, kur ai nuk është autori, madje as nuk është  
14 përfshirë fare në këto ngjarje, jashtë fushëveprimit fushës së  
15 kufizuar të përcaktuar në vendimin që refuzon pranimin e  
16 këtyre shënimeve.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne e kemi  
18 këtë çështje përpara nesh dhe për të do të japim vendim nesër.  
19 Nuk kemi nevojë t'i përsërisni të gjithë këto që po thoni, ne  
20 e kuptojmë qëndrimin tuaj.

21 Z. REES: [Përkthim] Po në qoftë se ju e kundërshtoni atë  
22 që ne kërkojmë, neve refuzojmë të merremi me ato çështje që  
23 thuhet që nuk janë ngritur në kohën e duhur, janë si të  
24 parakohshme të themi. Atëherë unë me kënaqësi e lë deri këtu  
25 në qoftë se ju do ta vendosni.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mbaroheni  
2 po bëheni brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

3 Z. REES: [Përkthim] Ne jemi përpjekur të merrmi me  
4 Prokurorinë e cila nuk i ka bërë përgatitjet e saj në kohë dhe  
5 që hapur refuzon që kur dështon përpiqet të na vërë ne në  
6 pozitë të vështirë. Ne kemi kërkuar deklaratën e dëshmitarit.  
7 E di që ju keni vendosur. Ne kemi bërë ç'është e mundur të  
8 identifikojmë se çfarë materialesh do të duhen në mënyrë të  
9 arsyeshme të bëhen të njohura për të punuar me dëshmitarin.  
10 Deri tani nuk kemi marrë gjë, vetëm një përmbledhje me tre  
11 paragrafë lidhur me atë që dëshmitari mund të thotë.

12 Nuk kemi marrë njoftim në bazë të rregullit 102(3). Është  
13 e qartë që janë çështje të rëndësishme, përderisa ata kërkojnë  
14 që të marrin dëshmi. E di që ZPS-ja nuk i pranon pasojat e  
15 vendimit të hershëm të Gjykatësit të Procedurës Penale dhe se  
16 nuk e përmbushi detyrimin e tyre për të prodhuar njoftim si në  
17 rregullit 102(3).

18 Ne nuk kemi marrë një njoftim të tillë në bazë të këtij  
19 rregulli të cilat lidhen me këto paragrafët e atij emaili, ne  
20 kemi bërë maksimumin tonë që ta identifikojmë çështjen,  
21 materialet që ata mund të kenë të cilat mund të kërkojnë nga  
22 ne për tu përgatitur për t'u marrë me këtë dëshmitar.

23 Përgjigja e tyre se kjo është tepër e gjerë ka të bëjë me  
24 faktin se ata duhet të na japin ne materiale shumë specifike  
25 të cilat ne duhet ti marrim si mbas rregullit, njoftimit në

1 bazë të rregullit 102(3).

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të  
3 bëjmë ç'është e mundur që të japim vendim për këtë nesër.  
4 Faleminderit shumë. Takohemi nesër përsëri në orën 9.30.

5 --- Seanca për sot përfundon në orën 15.37

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25